



# Trajtimi i **rasteve** **të terrorizmit** nga sistemi i drejtësisë penale të Kosovës

Shtator, 2022



Organizata për Siguri dhe  
Bashkëpunim në Evropë  
Misioni në Kosovë



# Trajtimi i rasteve të terrorizmit nga sistemi i drejtësisë penale të Kosovës

Shtator, 2022

# PËRMBAJTJA

<b>LISTA E SHKURTESAVE .....</b>	<b>3</b>
<b>1. PASQYRË PËRMBLEDHËSE .....</b>	<b>4</b>
<b>2. METODOLOGJIA.....</b>	<b>6</b>
<b>3. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE .....</b>	<b>7</b>
a. Metodologjia.....	8
<b>4. KORNIZA LIGJORE VENDORE DHE NDËRKOMBËTARE .....</b>	<b>9</b>
4.1. Kuadri ligjor dhe institucional në Kosovë .....	9
4.1.1. Kodet Penale të vitit 2012 dhe 2019 .....	9
4.1.2. Ligji për ndalimin e bashkimit në konflikte të armatosura jashtë territorit të vendit .....	17
4.1.3. Ligji për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit .....	17
4.1.4. E drejta procedurale .....	18
4.1.5. Ligji për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale .....	20
4.1.6. Strategjia e Kosovës kundër Terrorizmit dhe Plani i Veprimit 2018 – 2022	21
4.1.7. Korniza institucionale .....	23
4.2. Korniza ligjore ndërkombëtare.....	24
4.2.1. Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Terrorizmi .....	27
<b>5. RASTET E LIDHURA ME TERRORIZMIN NË KOSOVË 2018 - 2020.....</b>	<b>30</b>
5.1. Gjetjet kryesore .....	30
5.1.1. Diskutim rreth gjetjeve .....	32
5.1.2. Paraburgimi .....	33
5.1.3. Aktakuzat dhe përshtatshmëria e akuzave.....	34
5.1.4. Financimi i Terrorizmit .....	38
5.1.5. Gjykimet.....	40
5.1.6. Aktgjykimet dhe dënimet.....	41
<b>6. REKOMANDIME .....</b>	<b>48</b>
<b>7. PËRFUNDIME .....</b>	<b>50</b>
<b>SHTOJCA I .....</b>	<b>51</b>

## LISTA E SHKURTESAVE

<b>LPP/LFT</b>	Luftimi i pastrimit të parave/Luftimi i financimit të terrorizmit
<b>KPK</b>	Kodi Penal i Kosovës
<b>KPPK</b>	Kodi i Procedurës Penale të Kosovës
<b>KiE</b>	Këshilli i Evropës
<b>KEDNJ</b>	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore
<b>GJEDNJ</b>	Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
<b>BE</b>	Bashkimi Evropian
<b>NJIF</b>	Njësia e Inteligjencës Financiare
<b>OAK</b>	Oda e Avokatëve të Kosovës
<b>OSBE</b>	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
<b>ZKLDNJ</b>	Zyra e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut
<b>IUKT</b>	Instrumentet universale kundër terrorizmit
<b>OKB</b>	Organizata e Kombeve të Bashkuara
<b>EDHRÇT</b>	Ekstremizmi i dhunshëm dhe radikalizimi që çon në terrorizëm

## 1. HYRJE

*“Reagimet tona ndaj terrorizmit dhe përpjekjet tona për ta zbrapsur dhe parandaluar atë, duhet të respektojnë të drejtat e njeriut që terroristët synojnë t’i shkatërrojnë. Respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe sundimi i ligjit janë instrumente themelore në përpjekjet për luftimin e terrorizmit, jo privilegje që duhen sakrifikuar në kohëra tensionesh.”*

*ish-Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së, Kofi Annan (2003)*

Misioni në Kosovë i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) jep një kontribut gjithëpërfshirës në përpjekjet ndërkombëtare kundër terrorizmit të udhëhequra nga Kombet e Bashkuara.<sup>1</sup> Luftimi i terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm e radikalizimit që çon në terrorizëm (EDHRÇT) është prioritet për OSBE-në.

Terrorizmi paraqet një kërcënim të madh për paqen, sigurinë dhe stabilitetin. Ky raport përfshin disa nga fushat e fokusit strategjik të OSBE-së për aktivitetet kundër terrorizmit, përfshirë promovimin e zbatimit të kornizës ligjore ndërkombëtare kundër terrorizmit dhe rritjen e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në çështjet penale që lidhen me terrorizmin; parandalimin dhe shtypjen e financimit të terrorizmit; dhe promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në kontekst të masave kundër terrorizmit.<sup>2</sup>

Misioni i OSBE-së në Kosovë monitoron sektorin e drejtësisë për sa i përket respektimit të parimeve të sundimit të ligjit, gjyqimit të drejtë dhe standardeve të të drejtave të njeriut. Në kuadër të këtij monitorimi, prioritet u jepet rasteve të lidhura me terrorizmin në sistemin e drejtësisë penale të Kosovës. Që nga viti 2018, OSBE ka monitoruar mbi 200 seanca gjyqësore në afërsisht 50 raste të kualifikuara si vepra penale të terrorizmit ose në lidhje me terrorizëm. Qëllimi i këtij raporti është të analizojë të dhënat gjithëpërfshirëse në bazën e të dhënave të monitorimit të gjyqimeve dhe të konsolidojë gjetjet e monitoruesve të OSBE-së. Gjithashtu, raporti ofron një analizë gjithëpërfshirëse të kornizës ligjore ekzistuese për luftimin e terrorizmit në Kosovë dhe vlerëson shkallën e përputhshmërisë së kornizës në fjalë me të drejtën dhe standardet ndërkombëtare.

---

<sup>1</sup> Luftimi i terrorizmit. Gjetet tek <https://www.osce.org/countering-terrorism> (qasur më 28 tetor 2021).

<sup>2</sup> Po aty.

Raporti i mbështetë gjetjet në informatat e nxjerra nga baza e të dhënave të monitorimit të gjykimeve e OSBE-së, raportet e brendshme dhe intervistat e drejtpërdrejta.<sup>3</sup> Ai identifikon praktikën më të mira si dhe mangësitë në legjislacion, procedura dhe/ose praktikë.

Ky raport parashihet që të përdoret nga OSBE në mbështetje të avokimit për reformën legjislative dhe të politikave po të jetë e nevojshme, identifikimin e temave të ndërthurura dhe zhvillimin e aktiviteteve që synojnë ngritjen e kapaciteteve.

Ky raport u hartua nga dy konsulente ligjore të OSBE-së, Kirsty Brimelow KC,<sup>4</sup> dhe Maryam Mir. Kirsty Brimelow KC është avokate e specializuar në të drejtën penale dhe të drejtat ndërkombëtare të njeriut. Ajo është kryetare e Ekipit për të Drejtën Ndërkombëtare mbi të Drejtat e Njeriut në kuadër të avokaturës “Doughty Street Chambers”.<sup>5</sup> Ajo këshillon qeveritë për luftën kundër terrorizmit dhe të drejtat e njeriut. Maryam Mir është avokate në “Doughty Street Chambers” e specializuar në mbrojtjen penale, me fokus të veçantë në luftimin e terrorizmit.

OSBE dëshiron të falënderojë gjyqtarët, prokurorët, avokatët mbrojtës, Policinë e Kosovës (PK) dhe Njësinë e Inteligjencës Financiare (NJIF) për kohën, përkushtimin për progres dhe kontributin e mirëpritur për këtë raport.

---

<sup>3</sup> Të realizuara përmes platformës Zoom.

<sup>4</sup> Avokatët e Mbretit.

<sup>5</sup> Informatat e mëtejshme janë në dispozicion në: <https://www.doughtystreet.co.uk/>

## 2. PASQYRË PËRMBLEDHËSE

Terrorizmi vazhdon të përbëjë një prej kërcënimeve kryesore ndaj sigurisë globale, që kërcënon gëzimin e së drejtës për jetë, liri dhe integritetin fizik të viktimave. Kjo përbën ndërhyrje dhe shkelje të të drejtave të njeriut. Trendi botëror i terrorizmit dhe përhapjes së tij, veçanërisht gjatë dy dekadave të fundit, paraqet rrezik edhe për popullin e Kosovës.

Parandalimi dhe luftimi i terrorizmit mbetet një nga prioritetet e deklaruara strategjike të Qeverisë së Kosovës, me zotimet e bëra publikisht për t'i forcuar më tej mekanizmat ekzistues dhe për t'iu përshtatur trendeve dhe dinamikave aktuale të kërcënimeve terroriste. Duke njohur kërcënimet dhe pasojat e terrorizmit, në vitin 2009 Qeveria e Kosovës hartoi strategjinë e saj të parë kundër terrorizmit e cila, përveç themelimit të mekanizmave të nevojshëm, parashihte qasje gjithëpërfshirëse për parandalimin dhe luftimin e terrorizmit.

Shkalla në të cilën legjislacioni i Kosovës që e kriminalizon terrorizmin dhe prokuroria i trajton raste të tilla në përputhje me standardet ligjore vendore dhe ndërkombëtare ka qenë objekt i shqyrtimit të hollësishëm të vazhdueshëm nga OSBE-ja. OSBE-ja, në kuadër të mandatit të saj, vazhdon po ashtu të monitorojë sistemin e drejtësisë së Kosovës në mënyrë që të vëzhgojë nga afër nivelin e respektimit të të drejtave të njeriut, parimeve të sundimit të ligjit dhe standardeve të gjyqimit të drejtë.

Raporti analizon gjetjet e OSBE-së pas një periudhe trevjeçare të monitorimit të rasteve të terrorizmit prej 2018 deri 2020. Përmes analizës së Kodit aktual të procedurës penale, identifikimit të trendeve në praktikën e ndjekjes penale, shembujve ilustrues dhe intervistave të drejtpërdrejta me profesionistë të fushës dhe monitorues të gjykimeve, raporti ofron një pasqyrë të progresit të shënuar në fushën specifike të ndjekjes penale të rasteve të terrorizmit në Kosovë gjatë tre viteve të fundit. Duke identifikuar fushat ku kërkohet zhvillim i mëtejshëm, veçanërisht në sferat e forcimit të respektimit të standardeve të gjyqimit të drejtë, ndjekjes penale të financimit të terrorizmit dhe përmirësimit të praktikës së caktimit të dënimit, ky raport ofron rekomandime për hapat korrigjues që duhet të ndërmerren nga institucionet kyçe në Kosovë që merren me rastet e lidhura me terrorizmin për të siguruar respektimin efektiv të standardeve ligjore ndërkombëtare.



### 3. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Themelimi i dy departamenteve të specializuara në vitin 2019 (Departamenti për Terrorizëm në Prokurorinë Speciale dhe Departamenti Special në kuadër të Gjykatës Themelore të Prishtinës) dëshmoi një hap të rëndësishëm dhe pozitiv drejt forcimit të institucioneve të përkushtuara për ndjekjen e veprave penale të terrorizmit.

Gjyqtarët, prokurorët, PK, NJIF dhe avokatët mbrojtës që të gjithë kanë treguar shkallë të lartë përkushtimi dhe motivimi në trajtimin e rasteve që kanë të bëjnë me terrorizmin. Megjithatë, trupat institucionale vazhdojnë ende të përballen me mungesë të ekspertizës së specializuar, ndërsa praktikat nuk i përmbushin standardet e gjykimit të drejtë. Gjetjet kryesore të këtij raporti përfshijnë mangësitë në provat mbi të cilat mbështeten aktakuzat, mangësitë në arsyetimin për përdorimin e paraburgimit në pritje të gjykimit, vendimet me hollësi të pamjaftueshme me referencë në testin e provave si dhe problemet me zbulimin e shkresave në fazën e procedurës paraprake dhe paqartësia e kornizës ligjore për sa i përket zbulimit gjatë gjithë kohëzgjatjes së gjykimit.

Është e nevojshme që t'u kushtohet më tepër konsideratë lidhjeve ndërmjet rasteve individuale dhe grupeve terroriste, dhe që policia dhe prokurorët të përdorin mundësitë për të mbledhur informata nga të dyshuarit ose personat e dënuar. Një koment i dhënë hartueseve të këtij raporti në vazhden e hulumtimit ka qenë kritikues ndaj qëllimit të marrëveshjeve të pranimit të fajësisë, duke i parë ato si ekspeditive në kuptimin që personi pranon fajësinë, shpeshherë pavarësisht nga provat, dhe më pas lirohet. Shqetësime të përsëritura janë ngritur nga të intervistuarit edhe për sa i përket nocionit jozyrtar të krijuar se pranimi i fajësisë nënkupton dënim me kusht dhe, për rrjedhojë, lirim të menjëhershëm. Kështu, nxitet pranimi i fajësisë pavarësisht nga dëshmitë ekzistuese për provimin e fajësisë.

Ligji dhe praktika ekzistuese e ndjekjes penale në fushën e financimit të terrorizmit duhet të harmonizohet me standardet e BE-së dhe ato ndërkombëtare. Mungesa e mbikëqyrjes funksionale ka çuar në ndjekje penale joefektive në këtë fushë. Gjyqtarët, prokurorët dhe NJIF do të përfitonin nga trajnime të fokusuara në ndjekjen penale të financimit të terrorizmit dhe fushave të ndërthurjes me veprat penale të pastrimit të parave.

Politikëbërësit në qeveri janë nën tryzni të jashtëzakonshme që të duken sikur po ndërmarrin veprime pozitive në lidhje me kërcënimet terroriste dhe shpeshherë ballafaqohen me kërkesa konkurruese politike, logjistike dhe informacioni. Ka rrezik që nevoja për të dëshmuar se çështjet po procedohen nëpër gjykata t'i zë vendin efektivitetit në mbrojtjen e jetëve të njerëzve dhe që, në vend të atyre që janë në pozita organizative dhe rekrutuese për grupet terroriste, fokusi të drejtohet në caqe të lehta për t'u kapur.

Ky raport synon t'i mbështesë profesionistët ligjorë në Kosovë në mbajtjen e standardeve më të larta të profesionalizmit në këtë fushë sfiduese të ligjit dhe politikave.

## a. Metodologjia

Ky raport bazohet në:

- (i) vlerësimin cilësor dhe sasior të rasteve gjyqësore në lidhje me terrorizmin të monitoruara nga viti 2018 deri në vitin 2020;<sup>6</sup>
- (ii) vlerësimin e të dhënave të siguruara nga institucionet përkatëse të drejtësisë penale, gjegjësisht PK, Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK);
- (iii) tetë intervista dhe diskutime të drejtpërdrejta me përfaqësues të institucioneve përkatëse të drejtësisë penale, gjegjësisht zyrtarë policorë, prokurorë, gjyqtarë dhe avokatë;
- (iv) vëzhgimet e raportuara nga një grup i monitorimit sistematik të gjyqësorit nën mbikëqyrjen e OSBE-së.

Raporti bazohet në të dhënat nga vëzhgimet e monitoruesve të gjykimeve të OSBE-së gjatë 220 seancave gjyqësore në 54 raste të lidhura me terrorizmin, të monitoruara ndërmjet viteve 2018 dhe 2020 në tri gjykata themelore të Kosovës.<sup>7</sup>

---

6 Periudha e raportimit ka qenë nga 1 janari 2018 deri më 31 dhjetor 2020.

7 Numri i seancave gjyqësore për vepra penale të lidhura me terrorizmin janë monitoruar në secilën nga gjykatat themelore është sa vijon: Gjykata Themelore e Prishtinës – 210 seanca; Gjykata Themelore e Pejës – 8 seanca dhe Gjykata Themelore e Gjilanit – vetëm në 2 seanca. Ekipi monitorues i gjykimeve i OSBE-së nuk ka përfshirë të dhëna nga gjykatat tjera regjionale meqë në territoret e gjykatave tjera themelore, gjegjësisht Gjykatën Themelore të Mitrovicës, Gjykatën Themelore të Prizrenit, Gjykatën Themelore të Ferizajt dhe Gjykatën Themelore e Gjakovës, nuk ka pasur seanca gjyqësore për vepra penale të lidhura me terrorizmin as të regjistruara apo të monitoruara.

## 4. KORNIZA LIGJORE VENDORE DHE NDËRKOMBËTARE

### 4.1. Kuadri ligjor dhe institucional në Kosovë

Në legjislacionin e Kosovës, ndjekja penale e terrorizmit nuk është e kodifikuar me një ligj të vetëm, përkundrazi ligji mbulohet nga pjesë të ndryshme të legjislacionit:

- A. Kodi penal (2012)<sup>8</sup>
- B. Kodi penal (2019)<sup>9</sup>
- C. Ligji për ndalimin e bashkimit në konflikte të armatosura jashtë territorit të vendit
- D. Ligji për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit
- E. Ligji për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit

#### 4.1.1. Kodet Penale të vitit 2012 dhe 2019

Kodi penal i Kosovës i vitit 2012 (KPK),<sup>10</sup> është zëvendësuar rishtas nga KPK i vitit 2019. Të dy KPK-të kanë ngjashmëri, por KPK i vitit 2019 ka synuar të plotësojë boshllëqet në legjislacionin e mëparshëm në dy fusha kryesore: financimi i terrorizmit dhe udhëtimi për qëllime të terrorizmit. Në KPK-në e vitit 2012, Kreu XIV<sup>11</sup> i përmban 10 nene në lidhje me veprat e terrorizmit:

- Neni 136** Kryerja e veprës terroriste;
- Neni 137** Ndihma në kryerjen e terrorizmit;
- Neni 138** Lehtësimi në kryerjen e terrorizmit;
- Neni 139** Rekrutimi për terrorizëm;
- Neni 140** Trajnimi për terrorizëm;
- Neni 141** Shtytja për kryerjen e veprave terroriste;
- Neni 142** Fshehja ose moslajmërimi i terroristëve apo grupeve terroriste;
- Neni 143** Organizimi dhe pjesëmarrja në grup terrorist;
- Neni 144** Përgatitja e veprave terroriste ose veprave penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës;
- Neni 145** Parëndësia e kryerjes së veprës terroriste.

Përveç këtyre veprave, KPK i vitit 2012 specifikon tri vepra të tjera që lidhen me mosraportimin e akteve terroriste (përfshirë veprat e papërfunduara).<sup>12</sup>

<sup>8</sup> Kodi penal i Kosovës, nr. 04/L-082, 13 korrik 2012.

<sup>9</sup> Kodi penal i Kosovës, nr. 06/L-074, 14 janar 2019.

<sup>10</sup> Ka hyrë në fuqi më 1 janar 2013.

<sup>11</sup> Kodi penal i Kosovës, nr. 04/L-082, 13 korrik 2012.

<sup>12</sup> *Po aty*. Neni 385 (2) (2.4) Moslajmërimi i përgatitjes së veprave penale; Neni 386 (1.4) Moslajmërimi i veprave penale ose kryerësve të tyre dhe neni 388 (2) (2.4) Dhënia e ndihmës kryerësve pas kryerjes së veprave penale. Neni 145 i KPK përcakton: "Që një vepër të përbëjë vepër penale sipas neneve 135-144 të këtij Kapitulli, nuk është e nevojshme që vepra terroriste të jetë kryer".

Më 14 janar 2019, u publikua KPK i ri (hyri në fuqi tre muaj pas publikimit, më 14 prill 2019).<sup>13</sup> Kreu XIV i KPK të vitit 2019 përmban 11 nene që lidhen me veprat e terrorizmit, duke përfshirë veprën paraprake "parëndësia e kryerjes së veprës terroriste", ku specifikuar më tej se, që një vepër të përbëjë vepër penale të terrorizmit, nuk është e nevojshme që vepra terroriste të jetë kryer. Në Kodin e 2019-ës janë akoma të parapara aktet përgatitore të terrorizmit dhe pjesëmarrja/organizimi, ashtu si edhe veprat e papërfunduara.<sup>14</sup> Dënimet e parapara për këto nene nuk kanë ndryshuar nga KPK i vitit 2012.

Sa i përket përkufizimit të terrorizmit,<sup>15</sup> neni 135 i KPK-së së vitit 2012 e përkufizon terrorizmin për qëllimet e dispozitave të neneve 121-145 si vijon:

*“Terrorizëm, veprim terrorist apo vepër terroriste - nënkupton kryerja e një ose më shumë veprave penale të mëposhtme me qëllim të frikësimit serioz të popullsisë, të detyrimit të padrejtë të një organi publik, qeverisë apo organizatës ndërkombëtare për të kryer ose për të mos kryer ndonjë veprim, apo që seriozisht të destabilizojë ose të shkatërrojë strukturat themelore politike, kushtetuese, ekonomike apo shoqërore të Republikës së Kosovës, të një shteti tjetër apo të një organizate ndërkombëtare.”*

Lista e veprave penale përfshinë vrasjen, sulmin, ndotjen dhe rrëmbimin e mjeteve të transportit. Është dhënë po ashtu dhe një përkufizim i fondeve e burimeve financiare dhe grupit terrorist si vijon:

- i. *Shprehja “fonde” përfshin pasurinë e çfarëdo lloji, qoftë e prekshme ose e paprekshme, e luajtshme ose e paluajtshme, sido që të jetë fituar, dhe dokumentet apo instrumentet ligjore në çfarëdo forme, përfshirë formën elektronike ose digjitale, të dëshmuarit e pronësisë ose të interesit në pasuritë e tilla, përfshirë por pa u kufizuar në, kreditë bankare, çeqet e udhëtarëve, çeqet bankare, urdhërpagesat, aksionet, letrat me vlerë, detyrimet, çeqet dhe letër kreditë.*

<sup>13</sup> Kodi penal i Kosovës, nr. 06/L-074, 14 janar 2019; ka hyrë në fuqi në prill të vitit 2019.

<sup>14</sup> *Po aty*. Neni 377 (2) (2.4) Moslajmërimi i përgatitjes së veprave penale; Neni 378 (1.4) Moslajmërimi i veprave penale ose kryerësve të tyre dhe neni 380 (2) (2.4) Dhënia e ndihmës kryerësve pas kryerjes së veprave penale.

<sup>15</sup> Shih në Shtojcë diskutimin mbi përkufizimin e terrorizmit.

- ii. *Shprehja “burime financiare” përfshin, por nuk kufizohet në, dhënien me qira, objektet e trezorëve, dokumentacionin ose identifikimin e rrejshëm, shërbimet financiare, pajisjet, personelin, armët, mjetet e transportit, pajisjet e komunikimeve dhe pasurinë tjetër fizike, përveç medikamenteve të domosdoshme.*
- iii. *Shprehja “grup terrorist” nënkupton grupin e strukturuar prej më shumë se dy personave, që ekziston për një periudhë kohore dhe i cili vepron në bashkëpunim për kryerjen e terrorizmit. Grup i strukturuar nënkupton një grup i cili nuk është formuar rastësisht për kryerjen e menjëhershme të një vepre dhe i cili nuk ka nevojë të ketë role formalisht të përcaktuara për anëtarët e tij, vazhdimësinë e anëtarësisë ose strukturë të ndërtuar.”<sup>16</sup>*

Neni 136 i KPK-së së vitit 2012 prezanton veprën e terrorizmit:

- i. *“Kushdo që kryen një vepër terroriste dënohet me jo më pak se pesë (5) vjet burgim.*
- ii. *Kur vepra nga paragrafi 1 i këtij neni rezulton me lëndime të rënda trupore të një apo më shumë personave, kryesi dënohet me jo më pak se dhjetë (10) vjet burgim.”*

Në fund, nenet 137 - 144 të KPK-së së vitit 2012 parashohin veprat e bashkëpunimit dhe përgatitore të terrorizmit dhe në lidhje me terrorizmin. Neni 145 specifikon se nuk kërkohet që vepra e terrorizmit të jetë kryer.

Është e rëndësishme të theksohet data e hyrjes në fuqi të KPK-së së vitit 2019. Ai ka hyrë në fuqi tre muaj pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Kosovës<sup>17</sup> (neni 434).

Nenet e mësipërme në KPK-në e vitit 2012 janë identike në KPK-në e 2019, me të vetmin dallim që neni 128 është neni i ri 135, që përkufizon terrorizmin për qëllimet e neneve 114-139. Gjithashtu, është dhënë një përkufizim shtesë i grupit të strukturuar dhe terroristit si në vijim:

- i. *“Shprehja Grup i Strukturuar - nënkupton një grup i cili nuk është formuar rastësisht për kryerjen e menjëhershme të një vepre dhe i cili nuk ka nevojë të ketë role formalisht të përcaktuara për anëtarët e tij, vazhdimësinë e anëtarësisë ose strukturë të ndërtuar.*
- ii. *Terrorist - nënkupton çdo person fizik i cili: (i) kryen veprim terrorist me çfarëdo mjeti, drejtpërdrejt ose tërthorazi; (ii) organizon apo drejton të tjerët për të kryer veprime terroriste; ose (iii) kontribuon në kryerjen e veprimeve terroriste nga një grup personash që veprojnë me një qëllim të përbashkët, ku kontributi bëhet me dashje dhe me qëllim të avancimit të veprimit terrorist ose me njohjen e qëllimit të grupit për të kryer një veprim terrorist”.*

<sup>16</sup> Kodi penal i Kosovës, nr. 04/L-082, 13 korrik 2012, nenet 135 (2), 135 (3), 135 (4).

<sup>17</sup> Publikimi u bë më 14 janar 2019.

Neni 143 i KPK-së së vitit 2019 figuron si neni 136 i KPK-së së vitit 2019 dhe formulimi është i njëjtë:

- i. "Whoever Kushdo që krijon, organizon ose drejton një grup terrorist dënohet me gjobë deri në pesëqind mijë (500.000) Euro dhe me burgim prej dhjetë (10) deri në njëzet (20) vjet.*
- ii. Kushdo që merr pjesë në veprimtaritë e grupit terrorist dënohet me burgim prej pesë (5) deri në dhjetë (10) vjet".*

Zhvillimi më domethënës në KPK-në e vitit 2019 është shtimi i neneve që theksojnë kriminalizimin e financimit të terrorizmit. Neni 131 ngërthen lehtësimin dhe financimin e kryerjes së terrorizmit, duke i zgjeruar kompetencat e dënimit në dispozicion për financimin e terrorizmit nga pesë në deri në pesëmbëdhjetë vjet.<sup>18</sup>, dhe rritjen e gjobës në dispozicion në maksimum 500,000 €. <sup>19</sup> Neni 308 i KPK-së së vitit 2012 që kriminalizon pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit është bërë neni 302 i KPK-së së vitit 2019.

Shtim tjetër që vlen të përmendet është kriminalizimi i udhëtimit për qëllime terrorizmi, i paraparë me nenin 137 të KPK-së së vitit 2019, duke e sjellë kodin në përputhje me standardet ndërkombëtare për këtë aspekt.<sup>20</sup>

Si KPK i vitit 2012 ashtu edhe KPK i vitit 2019 përmbajnë një dispozitë për zbatimin e ligjit më të favorshëm (neni 3), gjegjësisht që ndaj kryerësit do të zbatohet ligji që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale dhe në rast se ligji në fuqi ndryshon para shqiptimit të vendimit të formës së prerë, atëherë ndaj kryesit zbatohet ligji që është më i favorshëm.

---

18 Neni 138 i Kodit penal të Kosovës, nr. 04/L-082, 13 korrik 2012.

19 Neni 131 i Kodit penal të Kosovës, nr. 06/L-074, 14 janar 2019.

20 Protokollin shtesë i Konventës së Këshillit të Evropës për parandalimin e terrorizmit parasheh përfshirjen e kësaj vepre penale në legjislacionin vendor. Shih nenin 4 paragrafin 2, i cili thotë: "Çdo palë miraton masa të tilla që mund të jenë të nevojshme për të përcaktuar "udhëtimin jashtë vendit për qëllime terrorizmi", siç përcaktohet në paragrafin 1, nga territori i saj ose nga shtetasit e saj, kur kryhet në mënyrë të kundërligjshme dhe të qëllimshme, si vepër penale në legjislacionin e saj të brendshëm. Duke vepruar kështu, çdo Palë mund të vendosë kushtet e kërkuara në përputhje me parimet e saj kushtetuese."

Kodi Penal 2012	Kodi Penal 2019
<p><b>Neni 136 “Kryerja e veprës terroriste”</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Kushdo që kryen një veprë terroriste dënohet me jo më pak se pesë (5) vjet burgim.</li> <li>2. Kur vepra nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me lëndime të rënda trupore të një apo më shumë personave, kryesi dënohet me jo më pak se dhjetë (10) vjet burgim.</li> <li>3. Kur vepra nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me vdekje të një apo më shumë personave, kryesi dënohet me burgim së paku pesëmbëdhjetë (15) vjet ose me burgim të përjetshëm.</li> </ol>	<p><b>Neni 129 “Kryerja e veprës terroriste”</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Kushdo që kryen një veprë terroriste dënohet me jo më pak se pesë (5) vjet burgim.</li> <li>2. Kur vepra nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me lëndime të rënda trupore të një apo më shumë personave, kryesi dënohet me jo më pak se dhjetë (10) vjet burgim.</li> <li>3. Kur vepra nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me vdekje të një apo më shumë personave, kryesi dënohet me burgim së paku pesëmbëdhjetë (15) vjet ose me burgim të përjetshëm.</li> </ol>
<p><b>Neni 137 “Ndhima në kryerjen e terrorizmit”</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Kur vepra nga neni 385 ose 386 i këtij Kodi kryhet në lidhje me terrorizmin, kryesi dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.</li> <li>2. Kur vepra nga neni 388 i këtij Kodi kryhet në lidhje me terrorizmin, kryesi dënohet me burgim prej tre (3) deri në dhjetë (10) vjet.</li> <li>3. Kushdo që e ndihmon kryesin apo bashkëpjesëmarrësin pas kryerjes së një veprë terroriste, duke i siguruar fonde ose burime të tjera materiale personave të tillë, dënohet me burgim prej tre (3) deri në dhjetë (10) vjet.</li> </ol>	<p><b>Neni 130 “Ndhima në kryerjen e terrorizmit”</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Kur vepra nga neni 377 ose 378 i këtij Kodi kryhet në lidhje me terrorizmin, kryesi dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.</li> <li>2. Kur vepra nga neni 380 i këtij Kodi kryhet në lidhje me terrorizmin, kryesi dënohet me burgim prej tre (3) deri në dhjetë (10) vjet.</li> <li>3. Kushdo që e ndihmon kryesin apo bashkëpjesëmarrësin pas kryerjes së një veprë terroriste, duke i siguruar fonde ose burime të tjera materiale personit apo personave të tillë për çfarëdo qëllimi, dënohet me burgim prej tre (3) deri në dhjetë (10) vjet.</li> </ol>
<p><b>Neni 138 “Lehtësimi në kryerjen e terrorizmit”</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Kushdo që në çfarëdo mënyre të drejtpërdrejtë ose të tërthortë ofron, kërkon, mbledh ose fsheh fonde apo mjete të tjera materiale me dashje, dijeni apo bazë të arsyeshme për të besuar se do të përdorën tërësisht ose pjesërisht për apo nga grupi terrorist, apo për kryerjen e veprës terroriste, dënohet me burgim prej pesë (5) deri në pesëmbëdhjetë (15) vjet.</li> <li>2. Kushdo që e ndihmon kryesin apo bashkëpjesëmarrësin pas kryerjes së një</li> </ol>	<p><b>Neni 131 “Lehtësimi dhe financimi në kryerjen e terrorizmit”</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Kushdo që, në çfarëdo mënyre, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, ofron, kërkon, mbledh ose fsheh, organizon, përgatit, vë në dispozicion fonde apo mjete të tjera materiale ose drejton të tjerët për këto veprime, me dashje se do të përdoren, dijeni apo bazë të arsyeshme për të besuar se do të përdoren, tërësisht ose pjesërisht, për apo nga një individ terrorist, grup terrorist, apo për të kryer apo për të kontribuar për kryerjen e veprës terroriste, dënohet me gjobë deri në pesëqind mijë (500.000) euro dhe me</li> </ol>

<p>vepre terroriste, duke i siguruar fonde ose burime të tj.</p>	<p>burgim prej pesë (5) deri në pesëmbëdhjetë (15) vjet.</p> <p>2. Që një vepër të përbëjë vepër penale sipas paragrafit 1 të këtij neni, nuk është e nevojshme që një veprim terrorist të ndodh ose nëse fondet janë përdorur në të vërtetë për të kryer një veprim të tillë terrorist.</p>
<p><b>Neni 139 “Rekrutimi për terrorizëm”</b> Kushdo që i bën thirrje personit tjetër për të kryer ose për të marrë pjesë në kryerjen e veprës terroriste, të marrë pjesë në aktivitetet e grupit terrorist apo të sigurojë fonde ose burime materiale, dënohet me burgim prej pesë (5) deri në pesëmbëdhjetë (15) vjet.</p>	<p><b>Neni 132 “Rekrutimi për terrorizëm”</b> Kushdo që i bën thirrje personit tjetër për të kryer ose për të marrë pjesë në kryerjen e veprës terroriste ose për të marrë pjesë në aktivitetet e një terroristi apo grupi terrorist, dënohet me burgim prej pesë (5) deri në pesëmbëdhjetë (15) vjet.</p>
<p><b>Neni 140 “Trajnimi për terrorizëm”</b> 1. Kushdo që ofron ose pranon trajnim për terrorizëm, dënohet me burgim prej pesë (5) deri në pesëmbëdhjetë (15) vjet.</p> <p>2. Për qëllime të këtij neni, shprehja “trajnim për terrorizëm” nënkupton trajnimin ose udhëzimin, përfshirë ofrimin ose pranimin e njohurive ose aftësive praktike, për prodhimin ose përdorimin e mjeteve shpërthyesë, armëve të zjarrit ose armëve tjera apo substancave kimike, bakteriologjike, nukleare apo substancave të tjera të dëmshme apo helmuese për njerëzit, pronën apo mjedisin, ose me metoda apo teknika tjera specifike, me qëllim që të kryejë apo të kontribuojë në kryerjen e veprës terroriste, duke ditur se shkathtësitë e mësuara apo të marra kanë për synim që të përdoren për këtë qëllim.</p>	<p><b>Neni 133 “Trajnimi për terrorizëm”</b> 1. Kushdo që ofron ose pranon trajnim për terrorizëm, dënohet me burgim prej pesë (5) deri në pesëmbëdhjetë (15) vjet.</p> <p>2. Për qëllime të këtij neni, shprehja “trajnim për terrorizëm” nënkupton trajnimin ose udhëzimin, përfshirë ofrimin ose pranimin e njohurive ose aftësive praktike, për prodhimin ose përdorimin e mjeteve shpërthyesë, armëve të zjarrit ose armëve tjera apo substancave kimike, bakteriologjike, nukleare apo substancave të tjera të dëmshme apo helmuese për njerëzit, pronën apo mjedisin, ose me metoda apo teknika tjera specifike, me qëllim që të kryejë apo të kontribuojë në kryerjen e veprës terroriste, duke ditur se shkathtësitë e mësuara apo të marra kanë për synim që të përdoren për këtë qëllim.</p>
<p><b>Neni 141 “Shtytja për kryerjen e veprave terroriste”</b> Kushdo që shpërndan, ose në ndonjë mënyrë tjetër mundëson mesazhin për publikun, me qëllim që të shtytë kryerjen e aktit terrorist, kur sjellja e tillë pavarësisht nëse avokon drejtpërdrejtë ose jo aktet terroriste, shkakton rrezikun që një ose më shumë vepra të tilla të kryhen, dënohet me burgim prej një (1) deri në pesë (5) vjet.</p>	<p><b>Neni 134 “Shtytja për kryerjen e veprave terroriste”</b> Kushdo që shpërndan, ose në ndonjë mënyrë tjetër mundëson me çdo mjet, mesazhin për publikun, me qëllim që të shtytë kryerjen e aktit terrorist, kur sjellja e tillë pavarësisht nëse avokon drejtpërdrejtë ose jo aktet terroriste, shkakton rrezikun që një ose më shumë vepra të tilla të kryhen, dënohet me burgim prej një (1) deri në pesë (5) vjet.</p>
<p><b>Neni 142 “Fshehja ose moslajmërimi i terroristëve dhe grupeve terroriste”</b> 1. Kushdo që fsheh ekzistimin e një grupi terrorist ose të anëtarëve të tij, e pengon</p>	<p><b>Neni 135 “Fshehja ose moslajmërimi i terroristëve dhe grupeve terroriste”</b> 1. Kushdo që fsheh ekzistimin e një terroristi apo grupi terrorist ose të anëtarëve të tij, e</p>



<p>zbulimin ose kapjen e grupit terrorist ose të anëtarëve të tij, dënohet me burgim prej tre (3) deri në dhjetë (10) vjet.</p> <p>2. Nëse vepra nga neni 385 ose 386 i këtij Kodi kryhet në lidhje me terrorizmin, kryesi dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.</p> <p>3. Nëse vepra nga neni 388 i këtij Kodi kryhet në lidhje me terrorizmin, kryesi dënohet me burgim prej tre (3) deri në dhjetë (10) vjet.</p>	<p>pengon zbulimin ose kapjen e grupit terrorist ose të anëtarëve të tij, dënohet me burgim prej tre (3) deri në dhjetë (10) vjet.</p> <p>2. Nëse vepra nga neni 377 ose 378 i këtij Kodi kryhet në lidhje me terrorizmin, kryesi dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.</p> <p>3. Nëse vepra nga neni 380 i këtij Kodi kryhet në lidhje me terrorizmin, kryesi dënohet me burgim prej tre (3) deri në dhjetë (10) vjet.</p>
<p><b>Neni 143 “Organizimi dhe pjesëmarrja në grup terrorist”</b></p> <p>1. Kushdo që organizon ose drejton një grup terrorist dënohet me gjobë deri në pesëqind mijë (500.000) Euro dhe me burgim prej dhjetë (10) deri në njëzet (20) vjet.</p> <p>2. Kushdo që merr pjesë në veprimtaritë e grupit terrorist dënohet me burgim prej pesë (5) deri në dhjetë (10) vjet.</p>	<p><b>Neni 136 “Organizimi dhe pjesëmarrja në grup terrorist”</b></p> <p>1. Kushdo që krijon, organizon ose drejton një grup terrorist dënohet me gjobë deri në pesëqind mijë (500.000) Euro dhe me burgim prej dhjetë (10) deri në njëzet (20) vjet.</p> <p>2. Kushdo që merr pjesë në veprimtaritë e grupit terrorist dënohet me burgim prej pesë (5) deri në dhjetë (10) vjet.</p>
	<p><b>Neni 137 “Udhëtimi për qëllime të terrorizmit”</b></p> <p>1. Kushdo që udhëton për në apo prej territorit të Republikës së Kosovës me qëllim për të kryer, kontribuar apo marrë pjesë në kryerjen e një vepre terroriste apo me qëllim për të marrë pjesë në aktivitetet e një terroristi apo grupi terrorist apo me qëllim të ofrimit apo pranimit të trajnimit për terrorizëm dënohet me burgim prej tre (3) deri në dhjetë (10) vite.</p> <p>2. Kushdo që në çfarëdo mënyrë ndihmon siç parashihet kryerja e veprës penale në këtë nen dhe siç përcaktohet në nenin 33 të këtij Kodi, organizon apo lehtëson udhëtimin e ndonjë personi me dijëni se udhëtimi është për qëllimet e parapara në paragrafin 1 të këtij neni dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vite.</p>
<p><b>Neni 144 “Përgatitja e veprave terroriste ose veprave penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës”</b></p> <p>1. Kushdo që përgatit kryerjen e veprave penale nga nenet 135-142 të këtij</p>	<p><b>Neni 138 “Përgatitja e veprave terroriste ose veprave penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës”</b></p> <p>1. Kushdo që përgatit kryerjen e veprave penale nga nenet 128-137 të këtij Kapitulli,</p>

<p>Kapitulli, dënohet me burgim prej një (1) deri në pesë (5) vjet.</p> <p>2. Për qëllime të këtij neni, shprehja “përgatitje e veprës penale” përfshin furnizimin apo aftësimin e mjeteve kryesve për kryerjen e veprës penale, eliminimin e pengesave për kryerjen e veprës penale, marrëveshjen, planifikimin apo organizimin me personat e tjerë për kryerjen e veprës penale, si dhe çfarëdo veprime tjera që krijojnë kushte për kryerjen e drejtpërdrejtë të veprës penale, por të cilat nuk e përbëjnë vet veprën penale.</p> <p>3. Kushdo që dërgon apo bartë në apo jashtë territorit të Republikës së Kosovës armë, eksploziv, helme, pajisje, municion apo material tjetër për kryerjen e një apo më shumë veprave penale nga ky kapitull, dënohet me burgim prej pesë (5) deri në pesëmbëdhjetë (15) vjet.</p> <p>4. Kushdo që me qëllim të kryerjes së një apo më shumë veprave terroriste nga ky Kapitull, dërgon apo bartë grupe te armatosura, pajisje ose burime tjera materiale në ose jashtë Republikës së Kosovës, dënohet me burgim prej dhjetë (10) deri në njëzet (20) vjet.</p>	<p>dënohet me burgim prej një (1) deri në pesë (5) vjet.</p> <p>2. Për qëllime të këtij neni, shprehja “përgatitje e veprës penale” përfshin furnizimin apo aftësimin e mjeteve kryesve për kryerjen e veprës penale, eliminimin e pengesave për kryerjen e veprës penale, marrëveshjen, planifikimin apo organizimin me personat e tjerë për kryerjen e veprës penale, si dhe çfarëdo veprime tjera që krijojnë kushte për kryerjen e drejtpërdrejtë të veprës penale, por të cilat nuk e përbëjnë vet veprën penale.</p> <p>3. Kushdo që dërgon apo bartë në apo jashtë territorit të Republikës së Kosovës armë, eksploziv, helme, pajisje, municion apo material tjetër për kryerjen e një apo më shumë veprave penale nga ky kapitull, dënohet me burgim prej pesë (5) deri në pesëmbëdhjetë (15) vjet.</p> <p>4. Kushdo që me qëllim të kryerjes së një apo më shumë veprave terroriste nga ky Kapitull, dërgon apo bartë grupe te armatosura, pajisje ose burime tjera materiale në ose jashtë Republikës së Kosovës, dënohet me burgim prej dhjetë (10) deri në njëzet (20) vjet.</p>
<p><b>Neni 145 “Parëndësia e kryerjes së veprës terroriste”</b></p> <p>Që një vepër të përbëjë vepër penale sipas neneve 135-144 të këtij Kapitulli, nuk është e nevojshme që vepra terroriste të jetë kryer.</p>	<p><b>Neni 139 “Parëndësia e kryerjes së veprës terroriste dhe lidhja me veprat penale terroriste”</b></p> <p>Që një vepër të përbëjë vepër penale sipas neneve 128-138 të këtij Kapitulli, nuk është e nevojshme që vepra terroriste të jetë kryer dhe as nuk është e nevojshme, për sa u përket veprave penale të përcaktuara në nenet 132, 133, 134 dhe 137 të këtij Kapitulli, për të krijuar një lidhje me një vepër tjetër penale në këtë Kod.</p>

Figura 1: Krahasim tabelori kodeve penale 2012/2019

#### **4.1.2. Ligji për ndalimin e bashkimit në konflikte të armatosura jashtë territorit të vendit**

Ligji për ndalimin e bashkimit në konflikte të armatosura jashtë territorit të vendit është miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 12 mars 2015. Ai në mënyrë të veçantë ndalon bashkimin në konfliktet e armatosura jashtë Kosovës.<sup>21</sup> Dispozita krijon një sërë veprash penale që lidhen me bashkimin në konflikte të tilla të armatosura<sup>22</sup> dhe: “ zbatohen ndaj çdo personi i cili merr pjesë apo organizon, rekruton, financon, nxit, udhëheqë apo trajnon personat ose grupe të personave me qëllim të bashkimit apo pjesëmarrjes në ushtrinë ose policinë e huaj, në formacionet e jashtme paraushtarake ose parapolicore, në organizimet grupore apo individuale, në çfarëdo forme të konflikteve të armatosura jashtë territorit të Republikës së Kosovës”<sup>23</sup> me dënime për shkeljet nga më së paku gjashtë muaj deri më së shumti 15 vjet burgim.

#### **4.1.3. Ligji për ndalimin e bashkimit në konflikte të armatosura jashtë territorit të vendit**

Ligji i mëparshëm për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit<sup>24</sup> në vitin 2010 themeloi Njif brenda Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (MEF) si një institucion qendror i pavarur, “përgjegjës për të kërkuar, marrë, analizuar dhe shpërndarë tek autoritetet kompetente, zbulimin e informacionit që kanë të bëjnë me pastrimin e mundshëm të parave dhe financimin e terrorizmit”.<sup>25</sup>

Ky ligj ishte cak i kritikave të vazhdueshme nga organizatat joqeveritare (OJQ) të cilat ankoheshin se përmbante shumë dispozita kufizuese, të cilat konsideroheshin jashtëzakonisht të rënda.

Ligji më i fundit nr. 05/L-096 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit<sup>26</sup> u miratua më 16 maj 2016 dhe hyri në fuqi më 15 qershor 2016.<sup>27</sup> Ai përmban pjesë të veçanta për kujdesin e duhur ndaj klientit si dhe krijimin e një bordi të pavarur. Si rezultat i angazhimit dhe avokimit intensiv nga organizatat e shoqërisë civile dhe Qendrës Evropiane për të Drejtën Jofitimprurëse (ECNL), ligji i ri shfuqizoi shumicën e dispozitave kufizuese para-ekzistuese. Megjithatë, ECNL pohon se disa

21 Ligji Nr. 05/L-002 për Ndalimin e Bashkimit në Konflikte të Armatosura Jashtë Territorit të Vendit, 2 Prill 2015.

22 *Po aty*. Neni 3 [Bashkimi apo pjesëmarrja në ushtrinë ose policinë e huaj, në formacionet e jashtme paraushtarake ose parapolicore, në organizimet grupore apo individualisht jashtë territorit të Republikës së Kosovës]

23 *Po aty*. Neni 2

24 Ligji nr. 03/L-196 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit, 9 nëntor 2010. Ligji Nr. 04/L-178 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-196 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit, 8 mars 2013.

25 *Po aty*. Neni 4

26 Përveç ligjit, në bazë të nenit 23, paragrafi 1, neni 35, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 i “Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës” (16 gusht 2010), neni 85, paragrafi 1 i “Ligjit nr. 04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare” dhe neni 66, paragrafi 2 i Ligjit nr. 05/L096 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit”, Bordi i Bankës Qendrore të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 nëntor 2016, ka miratuar Rregulloren për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit.

27 Ligji nr. 05/L-096 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit, 15 qershor 2016.

dispozita të mbetura për OJQ-të nuk janë në përputhje me standardet ndërkombëtare, duke përfshirë kufizimet në pranimin e donacioneve në para të gatshme dhe detyrimet për financimin e programeve të trajnimit kundër pastrimit të parave dhe kryerjen e një analize të rregullt profesionale. Si masa standarde për bankat dhe subjektet e qëndrueshme, ankesa është se këto detyrime vështirë se mund të zbatohen nga shumica e OJQ-ve të regjistruara, të cilat janë organizata të vogla dhe me bazë komuniteti.<sup>28</sup>

Ligji nr. 05/L-096 përcakton dënime nga pesë deri në 15 vjet burgim për shkelje të neneve të tij, me dënime financiare deri në 500,000 €. <sup>29</sup> Përkundër shënimit të përparimit që u lavdërua për kodifikimin e kriminalizimit të financimit të terrorizmit, Raporti i Progresit i BE-së për Kosovën i vitit 2019 gjeti se, "Ligji për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit nuk është plotësisht në përputhje me të drejtën e BE-së dhe standardet ndërkombëtare".<sup>30</sup> Sipas raportit: " Mangësitë kryesore në kornizën ligjore dhe institucionale mbeten; p.sh., (i) paqartësia e përgjegjësive së përbashkët mbikëqyrëse të sektorit financiar mes NjIF dhe Bankës Qendrore; (ii) mungesa e dënimeve financiare të synuara dhe masave për të siguruar privimin e plotë të pasurive të terroristëve; (iii) mangësi të konsiderueshme në lidhje me regjistrimin, monitorimin dhe mbikëqyrjen e OJQ-ve me qëllim të luftimit të financimit të terrorizmit; (iv) zbrazëtira të rëndësishme në regjimin e mbikëqyrjes, veçanërisht për sektorin jobankar; dhe (v) raportimi i pabarabartë dhe joefektiv i transaksioneve të dyshimta në të gjithë sektorët në lidhje me masat parandaluese."

Në janar të vitit 2021, në një intervistë me stafin e NjIF-it, u raportua se një projektligj që trajtonte këto çështje aktualisht ishte duke u debatuar me qëllim të trajtimit të këtyre mangësive.<sup>31</sup>

#### **4.1.4. E drejta procedurale**

Korniza gjithëpërfshirëse për trajtimin e personave dhe garancitë e të drejtave për individët e akuzuar për vepra terrorizmi përfshihet në Kodin e Procedurës Penale (KPP), i cili zbatohet në mënyrë të barabartë për të gjithë të dyshuarit për vepra penale.<sup>32</sup>

Janë disa shkurtime paksa të pazakonta brenda KPP-së në lidhje me të drejtën e të dyshuarve të përfshirë në akuza për vepra terroriste për të zgjedhur avokatin e tyre:

---

28 Deklarata e Fondacionit Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) në faqen e internetit:

<https://www.kcsfoundation.org/en/information-capacities/resources/environment-for-civil-society-2/law-on-the-prevention-of-money-laundering-and-financing-of-terrorism/> (qasur më 1 maj 2021).

29 Ligji Nr. 05/L-096 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimit të Financimit të Terrorizmit, 15 qershor 2016, Neni 57 [Vepra penale e Financimit të Terrorizmit].

30 Raporti për Kosovën i vitit 2019, Komisioni Evropian, Bruksel, 29.5.2019, fq. 34, në dispozicion në <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-kosovo-report.pdf>; (qasur më 1 shkurt 2021). Shih edhe: Projekti kundër krimit ekonomik në Kosovë (PECK II) <https://www.coe.int/en/web/corruption/completed-projects/peck2> (qasur më 11 tetor 2021).

31 Takimi me NjIF, 12 janar 2021.

32 Kodi i Procedurës Penale nr. 04/L-123, (28 dhjetor 2012), i ndryshuar me Ligjin nr. 06/L-091 për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të Procedurës Penale nr. 04/L-123 (4 korrik 2019).

## **Neni 166 Të drejtat e personit të arrestuar**

1. *“Personi i arrestuar ka të drejtë në ndihmë të menjëhershme të mbrojtësit pas arrestimit sipas zgjedhjes së tij.*
5. *“Kur personi i arrestuar dyshohet për terrorizëm ose krim të organizuar dhe ka arsye për të dyshuar se mbrojtësi i zgjedhur nga i arrestuari është i përfshirë në kryerjen e veprës penale ose se do të pengojë zbatimin e hetimeve, gjyqtari i procedurës paraprake me kërkesë të prokurorit të shtetit mund të urdhërojë caktimin e mbrojtësit tjetër që ta përfaqësojë të arrestuarin më së shumti shtatëdhjetë e dy (72) orë nga koha e arrestimit.”*

Dispozita nuk flet në lidhje me atë se çfarë barre provash duhet të provojë prokurori para gjyqtarit të procedurës paraprake për të vërtetuar pohimin se mbrojtësi është "i përfshirë në kryerjen e veprës penale" ose në të vërtetë në lidhje me atë çfarë lloj sjellje përbën një kërcënim të dukshëm se mbrojtësi "do të pengojë zhvillimin e hetimit". Duket se nuk është përcaktuar ndonjë dispozitë me anë të KPP për atë që avokati mbrojtës i dëmtuar të kundërshtojë çdo pretendim për pengim/përfshirje në vepër penale, dhe nuk jepet asnjë arsyetim se përse, pas frikës se avokati mbrojtës ishte disi i përfshirë në kuptimin negativ, kufizimi për qasjen në klient mund të hiqet 72 orë pas vendosjes së tij. Në mungesë të cilësimit të këtij supozimi ndëshkues të pakundërshtueshëm, është burim shqetësimi se neni 166 mund të çojë në keqpërdorime. E drejta për avokat mbrojtës sipas zgjedhjes së dikujt është një e drejtë e siguruar në juridiksione të shumta dhe një kufizim në dukje arbitrar i kësaj të drejte rrezikon të minojë paanshmërinë e procedurave në përgjithësi, veçanërisht gjatë fazës paraprake.

Prezumimi i pafajësisë përcaktohet në nenin 3 dhe e drejta për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm brenda një afati të arsyeshëm është përcaktuar me anë të nenit 5 të KPP. Neni 7 saktëson se gjykata, prokurori dhe policia që marrin pjesë në procedurë penale detyrohen që me vëmendje dhe me përkushtim maksimal profesional dhe me përkujdesje të njëjtë të vërtetojnë faktet kundër të pandehurit si dhe ato në favor të tij. Me fjalë të tjera, hetimi duhet të jetë në dijeni për provat, të cilat mund të largojnë fokusin e hetimit nga i pandehuri. Është e rëndësishme që këto prova t'i vihen në dispozicion të pandehurit "para fillimit dhe gjatë procedurës".<sup>33</sup> Detyra e prokurorit për të konsideruar prova fajësuese dhe shfajësuese përcaktohet në nenin 48 të KPP-së. Duket se nuk ka praktikë të rrënjosur të zbulimit të provave, e cila mund të minojë rastin e prokurorisë dhe ose të ndihmojë mbrojtjen. Kjo do të thotë se çdo rast trajtohet në baza të atypëratyshme dhe se zbulimi bëhet në mënyrë arbitrare.

Nenet 70 deri në 77 të KPP-së përcaktojnë autorizimet e policisë duke përfshirë të drejtën për të fotografuar një të dyshuar dhe për të marrë shenjat e gishtave të tij/saj. Nuk ka asnjë hollësi në lidhje me kohëzgjatjen e ruajtjes së tyre dhe asnjë konsideratë të qartë për të drejtat e një të dyshuari për privatësi, duke përfshirë shkatërrimin e informacionit privat.

---

33 Po aty. Neni 7(2).

Neni 9 i KPP-së përcakton të drejtën e të pandehurit për tu deklaruar për provat që janë në favor të tij/saj dhe për të marrë në pyetje dëshmitarët në favor apo kundër tij/saj. Neni 10 përcakton se gjatë arrestimit të tij/saj, i pandehuri menjëherë njoftohet në hollësi për llojin dhe shkaqet e akuzës kundër tij/saj në gjuhën që ai/ajo e kupton. Për më tepër, nenet 10 deri në 14 të KPP-së përfshijnë një sërë të drejtash të tjera të rëndësishme të të pandehurit, duke përfshirë të drejtat për mbrojtës, por me një kusht (dhe kështu kemi një kualifikim tjetër) "nëse kërkohet për interes të drejtësisë".<sup>34</sup>

Kapitulli V i KPP siguron hollësi të mëtejshme të drejtave të pandehurit për mbrojtës dhe ekzistojnë të drejta të kodifikuara për ata me probleme të shëndetit mendor. Megjithatë, në praktikë, na janë dhënë shembuj të rasteve kur këto garanci dhe masa mbrojtëse nuk janë marrë parasysh aq sa duhet ose aspak.

Dispozita të tjera të rëndësishme përfshijnë atë që moshën e një fëmije është nën moshën 18 vjeçare, ndërsa një person i mitur përkufizohet në mes moshës 14 dhe 18 vjeç.

Në lidhje me të drejtat e fëmijëve, korniza ligjore e Kosovës kryesisht është në përputhje me standardet ndërkombëtare, por zbatimi nuk është analizuar dhe raportohet se është i kufizuar.<sup>35</sup> Në korrik të vitit 2020, hyri në fuqi Ligji i ri për Mbrojtjen e Fëmijës.<sup>36</sup> Ai themelon një sistem të ri të integruar të mbrojtjes së fëmijëve, në nivel qendror dhe lokal. Është në fuqi një strategji dhe plan veprimi për të drejtat e fëmijëve për periudhën 2019-2023. Kjo mbetet një fushë e rëndësishme e fokusit pasi shumë fëmijë mbeten në kampe në Siri dhe mund të dëshirojnë të hyjnë/kthehen në Kosovë në të ardhmen e afërt.

Në lidhje me provat thashetheme, është kodifikuar se provat janë në thelb të pabesueshme nëse prejardhja e provave ose informacionit është e panjohur, nëse bazohet në thashetheme ose është informacion që është i pamundur ose i papërfytyrueshëm.<sup>37</sup>

Sipas nenit 22 të KPP, veprat e lidhura me terrorizmin cilësohen si vepra të rënda.

#### **4.1.5. Ligji Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet**

Në vitin 2013, Kuvendi i Kosovës miratoi Ligjin për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale,<sup>38</sup> që përcakton kushtet dhe procedurat për bashkëpunim juridik në çështjet penale mes Kosovës dhe vendeve tjera, përveç nëse nuk është përcaktuar ndryshe me marrëveshje ndërkombëtare. Për më tepër, ligji *ndër të tjera* rregullon rregullat dhe procedurat për ekstradimin; transferimin e procedurës penale; transferimin e dënimit; njohjen dhe zbatimin e vendimeve të ndihmës juridike të ndërsjellë; paraqitjen

<sup>34</sup> *Po aty*. Neni 11 (4).

<sup>35</sup> Shih Raportin e KE-së për Kosovën të vitit 2020 në dispozicion në [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/kosovo\\_report\\_2020.pdf](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/kosovo_report_2020.pdf) (qasur më 24 maj 2021)

<sup>36</sup> Ligji Nr. 06/L-084 për mbrojtjen e fëmijës, 17 korrik 2019.

<sup>37</sup> Kodi i Procedurës Penale nr. 04/L-123, neni 19 1.16 dhe 1.17 dhe 1.29.

<sup>38</sup> Ligji nr. 04/L-213 për Bashkëpunimin Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale, 2 shtator 2013.

e dëshmitarëve, ekspertëve dhe të pandehurve; të dhënat gjyqësore dhe format e tjera bashkëpunimi përkatës për hetimin mes vendeve të veprave të terrorizmit.

Në këtë kontekst, bashkëpunimi në çështjet penale që lidhen me terrorizmin realizohet me qëllim të parandalimit dhe shtypjes së veprave të tilla. Megjithatë, mekanizmat për bashkëpunim janë po aq efektive sa ç'është zbatimi i tyre praktikë.

Projekti i Këshillit të Evropës kundër Krimet Ekonomik në Kosovë (PECK II) shqyrtoi nivelin e pajtueshmërisë në Kosovë me 40 rekomandimet e Task Forcës për Veprim Financiar (FATF) dhe Direktivën e BE-së (2015) 849.<sup>39</sup> Sa i përket aspekteve financiare të rasteve të lidhura me terrorizmin, u konstatua se institucionet e Kosovës kishin mangësi veçanërisht në zbatimin e një sistemi gjithëpërfshirës të sanksioneve financiare të synuara. Kuadri ligjor mbetet i mangët, ku raportimi i transaksioneve të dyshimta është ende i pabarabartë.

Subjekti raportues	2014	2015	2016	2017
<b>Bankat</b>	<b>15</b>	<b>23</b>	<b>19</b>	<b>10</b>
<b>Të tjerë, duke përfshirë:</b>	<b>1</b>	<b>3</b>	<b>17</b>	<b>8</b>
Mbikëqyrës			(1)	
Biznes ose profesion i caktuar jo financiar			(15)	(8)
<b>Gjithsej</b>	<b>16</b>	<b>26</b>	<b>36</b>	<b>18</b>

Figura 2: Kërkesat për transaksione të dyshimta që janë pranuar nga Njësia e Hetimeve Financiare. Burimi: Projekti i Këshillit të Evropës kundër Krimet Ekonomik në Kosovë (PECK II)<sup>40</sup>

#### 4.1.6. Strategjia Kosovës kundër Terrorizmit dhe Plani i Veprimit 2018 – 2022

Strategjia e Kosovës kundër Terrorizmit dhe Plani i Veprimit 2018-2020 i zhvilluar nga qeveria përcakton një strategji që bazohet në katër shtylla ose objektiva strategjike që janë të harmonizuara me Strategjinë e BE-së kundër terrorizmit.<sup>41</sup>

39 Direktiva (BE) 2015/849 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 20 maj 2015 (Gazeta Zyrtare e Bashkimit Evropian L141/73, 5.6.2015) <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A32015L0849> (qasur më 2 shkurt 2021).

40 Raporti i Vlerësimit për respektimin nga ana e Kosovës të standardeve ndërkombëtare kundër pastrimit të parave dhe luftimit të financimit të terrorizmit, Projekti kundër Krimet Ekonomik në Kosovë (PECK II), 2018 në faqen 81; në dispozicion në: <https://rm.coe.int/assessment-report-on-compliance-of-kosovo-with-international-anti-money/16809381e1> (qasur më 24 maj 2021)

41 Strategjia e Bashkimit Evropian kundër Terrorizmit, 2005, në dispozicion në <https://data.consilium.europa.eu/doc/document/ST%2014469%202005%20REV%204/EN/pdf> (qasur më 24 maj 2021).



*“Parandalimi që ka për qëllim parandalimin e terrorizmit përmes identifikimit dhe kundërshtimit të shkaktarëve, respektivisht kundërshtimit të ideologjive dhe doktrinave radikale të cilat nxisin individët në akte të dhunës.*

*Mbrojtja, përmes së cilës do të forcohen kapacitetet mbrojtëse të institucioneve ndaj sulmeve terroriste, respektivisht kërcënimeve të terrorizmit që i paraqiten Republikës së Kosovës ose të interesave të saj në rajon dhe më gjerë. Përveç forcimit të kapaciteteve mbrojtëse, janë planifikuar edhe masa specifike në minimizimin e cenueshmërisë nga ky fenomen.*

*Ndjekja, përmes së cilës agjencitë e zbatimit të ligjit do të ndjekin, hetojnë dhe sjellin para drejtësisë individët apo grupet që paraqesin kërcënim terrorist apo kryejnë vepra terroriste.*

*Reagimi, i cili ka për qëllim përgatitjen e institucioneve në menaxhimin dhe minimizimin e pasojave të një sulmi potencial terrorist. Përgatitja dhe reagimi efektiv janë me rëndësi kritike për të shpëtuar jetën dhe për të minimizuar dëmet dhe pasojat e mundshme.”*

Si përmbledhje, strategjia përforcon se përgatitja dhe reagimi efektiv janë me rëndësi kritike për shpëtimin e jetëve dhe minimizimin e dëmeve dhe pasojave të mundshme të terrorizmit.<sup>42</sup>

Plani i veprimit gjithashtu e mbështet strategjinë e tij në parimet themelore të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, pra veprimet e ndërmarra për të luftuar terrorizmin duhet të bazohen në dispozitat e Kushtetutës dhe legjislacionin në fuqi. Duhet të ekzistojë një qasje gjithëpërfshirëse që është efektive në parandalimin dhe luftimin e kërcënimeve terroriste. Kjo arrihet përmes një qasjeje gjithëpërfshirëse ndaj kësaj çështjeje nga të gjitha institucionet qeveritare, institucionet publike, shoqëria civile, sektori privat dhe organizatat ndërkombëtare. Respektimi i të drejtave dhe lirive të njeriut duhet të jetë parësor – do të thotë garantimi i të drejtave dhe lirive i të gjithë individëve gjatë të gjitha fazave të përfshirjes institucionale në parandalimin dhe luftimin e terrorizmit. Kjo përfshin, por nuk kufizohet në, ruajtjen e fshehtësisë, përkatësisht institucionet përgjegjëse për parandalimin dhe luftimin e terrorizmit duhet të sigurojnë mbrojtjen e fshehtësisë të informacionit gjatë fazës së hetimit dhe proceseve përkatëse dhe promovimin e bashkëpunimit dhe bashkërendimit të aktiviteteve ndërmjet institucioneve për të siguruar efikasitet dhe kanalet e duhura të komunikimit. Më gjerësisht, bashkëpunimi ndërmjet juridiksioneve është thelbësor në luftën kundër krimit të rëndë global.

---

<sup>42</sup>Në faqet 16 deri në 18, Strategjia e Kosovës kundër Terrorizmit dhe Plani i Veprimit 2018-2020 përshkruan katër shtyllat e strategjisë në përputhje me ato të përcaktuara në Strategjinë e BE-së kundër terrorizmit.



#### 4.1.7. Korniza institucionale

Policia, prokuroria dhe gjykatat janë institucionet kyçe të përfshira në hetimin, ndjekjen penale dhe gjykimin e rasteve të terrorizmit në Kosovë, të mbështetura nga Agjencia e Inteligjencës dhe NjIF. Ky raport përqendrohet në punën e institucioneve të sistemit të drejtësisë, përkatësisht policisë, prokurorisë dhe gjykatave të përfshira në trajtimin e rasteve të lidhura me terrorizmin.

Drejtoria kundër Terrorizmit në kuadër të Divizionit për Hetimin e Krimeve të Policisë së Kosovës është themeluar në tetor të vitit 2006, si njësi e specializuar kryesisht për të hetuar rastet e ndërlidhura me terrorizmin që janë në juridiksionin e Kosovës.<sup>43</sup>

Prokuroria Speciale e Kosovës, me seli në Prishtinë, është institucioni kryesor përgjegjës për hetimin dhe ndjekjen penale të rasteve të lidhura me terrorizmin. Ky departament relativisht i ri rregullohet me anë të Ligjit për Prokurorinë Speciale<sup>44</sup> dhe ka mbikëqyrjen e tërë territorit të shtatë Gjykatave Themelore, duke përfshirë Gjykatën Themelore të Prishtinës dhe Departamentin Special, që gjykon rastet e lidhura me terrorizmin.

Para janarit të vitit 2020, ndjekja penale e veprave të terrorizmit nuk ishte e specializuar në këtë mënyrë, të gjitha sjelljet kriminale trajtoheshin nga një njësi e vetme, më e gjerë e krimit. Që nga shkurti i vitit 2020, Zyra e Prokurorisë Speciale miratoi një strategji të brendshme riorganizimi, duke themeluar për herë të parë një departament të veçantë për terrorizmin, i përbërë nga dy prokurorë, të cilët janë të përqendruar vetëm në hetimin dhe ndjekjen penale të të gjitha krimeve të lidhura me terrorizmin.<sup>45</sup>

Ky ndryshim strukturor që solli specializimin e ndjekjeve terroriste u shtri edhe në gjykata pas qershorit të vitit 2019,<sup>46</sup> me themelimin e Departamentit Special në Gjykatën Themelore të Prishtinës.<sup>47</sup> Departamenti Special aktualisht funksionon me 12 gjyqtarë.<sup>48</sup>

Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën 2020 (Raporti i KE-së)<sup>49</sup> konsideroi se ishte bërë përparim në luftën kundër terrorizmit, në përputhje me objektivat e përcaktuara në marrëveshjen zbatuese BE-Kosovë për Planin e Përbashkët të Veprimit kundër terrorizmit për Ballkanin Perëndimor, veçanërisht në lidhje me rehabilitimin dhe reintegrimin e luftëtarëve të huaj terroristë dhe familjet e tyre. Megjithatë, janë identifikuar dobësi në luftimin e pastrimit të parave. Gjithashtu, Kosova mbetet pa një marrëveshje të

43 Më 27 dhjetor të vitit 2017, kjo Drejtori ka miratuar Procedurat Standarde të Veprimit (PSV), ndërsa nga data 28 shkurt të vitit 2019 Drejtoria ka një strukturë të re organizative, me rreth 50 punonjës. Kjo u konfirmua në gusht të vitit 2020 në një takim të OSBE-së dhe përfaqësuesve të Drejtorisë kundër Terrorizmit. Informacione shtesë për rolin dhe kompetencat e Drejtorisë mund të gjenden në ueb-faqen e Policisë së Kosovës, në dispozicion në <https://www.kosovopolice.com/en/departments/investigation-department/>

44 Ligji nr. 03/L-052 për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës, 3 qershor 2008.

45 Strategjia për Riorganizimin e Prokurorisë Speciale të Kosovës (shkurt 2020), në dispozicion në <https://prokuroria-rks.org/assets/cms/uploads/files/Dokumente%20Publikime/PSH/Dokumente%20Strategjike/Strategjia%20per%20Riorganizimin%20e%20PSRK-se%20-%20Versioni%20ne%20Gjuhen%20Angleze.pdf> (qasur më 2 shkurt 2021).

46 Neni 15 (1) (1.1) (1.20), Ligji nr. 03/L-199 për Gjykatat, 24 gusht 2010, i shfuqizuar me Ligjin nr. 06/L-054 për Gjykatat, 18 dhjetor 2018.

47 Neni 42, neni 13 (1) (1.1) në lidhje me nenin 18 (1) (2), Ligji nr. 06/L-054 për Gjykatat, 18 dhjetor 2018.

48 Shtatë gjyqtarë burra dhe tre gra.

49 Dokumenti i Punës së Stafit të Komisionit - Raporti për Kosovën i vitit 2020, Bruksel, 06.10.2020 SWD (2020) 356 final [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/kosovo\\_report\\_2020.pdf](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/kosovo_report_2020.pdf) (qasur më 4 shkurt 2).

strukturuar me Europolin. Kjo është komentuar në disa nga intervistat e OSBE-së për këtë raport. Plani i Përbashkët i Veprimit do të përbëjë bazën për bashkëpunim të zgjeruar ndërmjet Policisë së Kosovës, Europolit dhe Shteteve Anëtare të BE-së, në veçanti për trajtimin e terrorizmit dhe ekstremizmit, si dhe krimit të organizuar. Ai gjeti se *"konfiskimi i aseteve mbetet i ulët"*.

Përveç kësaj, Raporti i KE-së ka gjetur se administrimi i drejtësisë në Kosovë mbetet i ngadalshëm dhe joefikas. Operacionalizimi i një sistemi elektronik të menaxhimit të lëndëve dhe themelimi i një sistemi qendror të dosjeve kriminale raportohet se kanë shënuar përparim të mirë. Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës kanë ndërmarrë përpjekje për të zbatuar legjislacionin përkatës për funksionimin e sistemit të tyre elektronik të menaxhimit të lëndëve dhe themelimit të dosjeve qendrore penale.

Megjithatë, OSBE-ja nuk gjeti prova për të mbështetur përdorimin praktik e efikas të një sistemi elektronik për të shërbyer shkresat e lëndës, ku janë dhënë shembuj të materialit të kopjuar në disk pa ndonjë sistem të bërë zyrtar për sigurinë e ruajtjes. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në rastet shumë të ndjeshme dhe ato që mund të kenë implikime më të gjera të sigurisë.

#### **4.2. Korniza ligjore ndërkombëtare**

Disa instrumente juridike ndërkombëtare që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut dhe liritë themelore janë drejtpërdrejt të zbatueshme në Kosovë dhe, në rast konflikti, kanë prioritet mbi të gjitha ligjet vendore dhe aktet ligjore të institucioneve publike.<sup>50</sup> Për më tepër, institucionet e kanë obligim kushtetues për të interpretuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut duke e pasur parasysh dhe në përputhje me praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.<sup>51</sup>

Sa i përket kornizës ligjore ndërkombëtare për luftën kundër terrorizmit, 19 Instrumentet Universale kundër Terrorizmit (IUKT) mbeten instrumentet kryesore ligjore ndërkombëtare.<sup>52</sup> Edhe pse këto instrumente nuk janë drejtpërdrejt të zbatueshme në Kosovë, ato ofrojnë një udhëzues të rëndësishëm në bazë të së cilit mund të vlerësohet e drejta e Kosovës në këtë fushë.<sup>53</sup> Përmbledhja e mëposhtme e pikave të rëndësishme për instrumentet kyçe ligjore ndërkombëtare janë përfshirë si një udhëzues që mund të ndihmojë në informimin e politikave dhe praktikës në Kosovë.

50 Kushtetuta e Kosovës, neni 22, 15 qershor 2008.

51 *Po aty*. Neni 53

52 Organizata e Kombeve të Bashkuara, Zyra e Kundër Terrorizmit, Instrumentet Ligjore Ndërkombëtare. Në dispozicion në <https://www.un.org/counterterrorism/international-legal-instruments> (qasur më 29 gusht 2020).

53 Sipas OSBE-së, shkalla e ratifikimit të IUKT ndër shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së mbetet përafërsisht në 75 për qind dhe në mesin e Partnerëve të OSBE-së për Bashkëpunim, këto norma ratifikimi janë përafërsisht 77 për qind, përkatësisht 70 për qind. Statusi i Konventave dhe Protokolleve Universale kundër Terrorizmit në zonën e OSBE-së, fq. 4 (OSBE, 1 gusht 2018). Në dispozicion në <https://www.osce.org/atu/17138> (qasur më 29 gusht 2020).

Në vitin 2005, Këshilli i Evropës miratoi një Konventë të re kundër shpëlarjes, kërkimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e të ardhurave nga krimi dhe financimin e terrorizmit, duke përditësuar dhe zgjeruar Konventën e tij të vitit 1990, duke marrë parasysh faktin se financimi i terrorizmit gjithashtu mund të vij nga aktivitete të ligjshme, jo vetëm nga pastrimi i parave dhe aktivitete të tjera të paligjshme. Ky traktat i ri ndërkombëtar, për herë të parë, trajton parandalimin dhe kontrollin e shpëlarjes së parave dhe financimin e terrorizmit.<sup>54</sup> Qasja përfshin realitetin që financimi i terrorizmit nuk është plotësisht i ndarë nga shpëlarja e parave; kjo pasqyrohet më vonë në këtë raport.<sup>55</sup>

Në të njëjtin vit, 2005, Këshilli i Evropës miratoi Konventën për Parandalimin e Terrorizmit që mëtonte përmirësimin e efektivitetit të instrumenteve ligjore ndërkombëtare në luftën kundër terrorizmit. Kjo Konventë saktëson, *ndër të tjera*, se disa akte të tilla si provokimi publik, rekrutimi dhe trajnimi, të cilat mund të çojnë në kryerjen e veprave terroriste, përbëjnë vepra penale. Ajo i bën thirrje secilës palë që të ndërmarrë masa adekuate për të siguruar që vepra të tilla penale miratohen në legjislacionin vendas.<sup>56</sup> Në vitin 2015, Këshilli i Evropës miratoi më pas një **Protokoll Shtesë për të plotësuar këtë Konventë (Protokoll) në lidhje me** kriminalizimin e akteve të pjesëmarrjes në një shoqatë ose grup për qëllime terrorizmi; duke marrë trajnime për terrorizëm; udhëtimin jashtë vendit për qëllime terrorizmi dhe financimin dhe organizimin e udhëtimeve; për qëllime terrorizmi.<sup>57</sup> Përveç kësaj, me qëllim të lehtësimit të shkëmbimit të shpejtë të informacionit mes Palëve, Protokollin parashikon gjithashtu përcaktimin e pikave të kontaktit gjatë 24-orëve, shtatë ditëve në javë.<sup>58</sup> Më tej, protokollin zgjeron fushëveprimin e Konventës për të mbuluar të gjitha veprat penale të përfshira në Konventën kundër Terrorizmit të Kombeve të Bashkuara dhe Protokollet e saj. Ai përfshin gjithashtu dispozita të reja që lejojnë refuzimin e ekstradimit në një vend, ku personi që i nënshtrohet ekstradimit rrezikon të dënohet me vdekje ose t'i nënshtrohet torturës.<sup>59</sup>

Në vitin 2015, Parlamenti Evropian dhe Këshilli miratuan së bashku Direktivën (BE) 2015/849 të datës 20 maj 2015 për parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të shpëlarjes së parave ose financimit të terrorizmit, duke ndryshuar Rregulloren (BE) nr. 648 /2012 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, dhe duke shfuqizuar Direktivën 2005/60/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit dhe Direktivën e Komisionit 2006/70/EC (tekst me rëndësi për ZEE).<sup>60</sup>

---

54 Konventa e Këshillit të Evropës kundër shpëlarjes, kërkimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e të ardhurave nga krimi dhe mbi financimin e terrorizmit, Varshavë, 16.V.2005, CETS nr.198. Në dispozicion në <https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list/-/conventions/treaty/198> (qasur më 02 shtator 2020).

55 *Po aty*. Shih Kapitullin II - Financimi i Terrorizmit.

56 Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin e Terrorizmit, Varshavë, 16.V.2005, CETS nr.196. Në dispozicion në <https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list/-/conventions/treaty/196> (qasur më 2 shtator 2020).

57 **Protokollin Shtesë i Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin e Terrorizmit, Riga, 22.X.2015, CETS nr.217** Në dispozicion në <https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list/-/conventions/rms/090000168047c5ea> (qasur më 4 shkurt 2021).

58 *Po aty*. Neni 7

59 Protokollin për ndryshimin e Konventës Evropiane për Shtypjen e Terrorizmit, Strasburg, 15.V.2003, ETS nr.190. Në dispozicion në <https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list/-/conventions/treaty/190> (qasur më 2 shtator 2020).

60 Direktiva (BE) e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 20 maj 2015; (Gazeta Zyrtare e Bashkimit Evropian 5.6.2015, L141/73). Në dispozicion në <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32015L0849&from=EN> (qasur më 4 shkurt 2021).

Përveç kësaj, Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Transnacional<sup>61</sup> së bashku me traktatet e tjera brenda kornizës së Këshillit të Evropës përbëjnë instrumente të mëtejshme ligjore ndërkombëtare në fushën e bashkëpunimit në hetimet penale dhe ndjekjen penale të terroristëve të dyshuar. Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Transnacional “u bën thirrje të gjitha shteteve të njohin lidhje të tilla ndërmjet krimit të organizuar transnacional dhe krimit terrorist”.

Konventa Evropiane për Ekstradimin dhe Katër Protokollet e saj Shtesë ofrojnë një mjet me të cilin qeveritë mund të punojnë me Kosovën në lidhje me disa vepra penale, përfshirë terrorizmin.<sup>62</sup> OSBE-ja u informua nga disa persona të cilët u intervistuan së fundi, se kishte një rast të suksesshëm të ekstradimit mes Kosovës dhe Gjermanisë. Kjo u paraqit si një provë pozitive e bashkëpunimit më të madh me Kosovën në Evropë.

Konventa Evropiane për Ndhimën e Ndërsjellë në Çështjet Penale me dy protokollet e saj shtesë synon avancimin e bashkëpunimit ndërmjet palëve me synim mbledhjen e provave, dëgjimin e dëshmitarëve, ekspertëve dhe personave të ndjekur penalisht, etj.<sup>63</sup> Një Protokoll shtesë gjithashtu avancoi bashkëpunimin gjyqësor në fushën e shkëmbimit të protokolleve gjyqësore.<sup>64</sup> Protokollin i Dytë Shtesë thjeshton procedurat e bashkëpunimit.<sup>65</sup> Gjatë përgatitjes së këtij raporti, OSBE-ja vuri në pah mungesën e njohjes me këto traktate ndër disa prej palëve të interesuara të cilët u intervistuan.

Konventa evropiane për transferimin e procedurës në rastet penale i lejon palët të kërkojnë që një palë tjetër të fillojë procedurën penale në emër të tyre.<sup>66</sup> Për më tepër, Konventa për pastrimin, depistimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e produkteve të krimit përmirëson bashkëpunimin juridik ndërkombëtar në fushën e hetimit të krimit, sekuestrimi, ngrirjes dhe konfiskimit të pasurive.<sup>67</sup>

Konventa për krimin kibernetik është traktati i parë ndërkombëtar për krimet e kryera përmes internetit dhe rrjeteve të tjera kompjuterike. Kjo Konventë synon të krijojë politikë

---

61 Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Transnacional Miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së: 15 nëntor 2000, me rezolutën 55/25, Hyrja në fuqi: 29 shtator 2003, në dispozicion në <https://www.unodc.org/unodc/en/organized-crime/intro/UNTOC.html> (qasur më 30 gusht 2020).

62 Këshilli i Evropës, Konventa Evropiane për Ekstradimin, Paris, 13.XII.1957, ETS nr.024. Në dispozicion në <https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list/-/conventions/treaty/024> (qasur më 30 gusht 2020).

63 Këshilli i Evropës, Konventa Evropiane për Ndhimën e Ndërsjellë në Çështjet Penale, Strasburg, 20.IV.1959, ETS nr.030. Në dispozicion në <https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list/-/conventions/treaty/030> (qasur më 2 shtator 2020).

64 Protokollin Shtesë i Konventës Evropiane për Ndhimën e Ndërsjellë në Çështjet Penale Strasburg, 17.III.1978, ETS nr.99. Në dispozicion në <https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list/-/conventions/treaty/099> (qasur më 2 shtator 2020).

65 Protokollin i Dytë Shtesë i Konventës Evropiane për Ndhimën e Ndërsjellë në Çështjet Penale, Strasburg, 8.XI.2001, ETS nr.182. Në dispozicion në <https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list/-/conventions/treaty/182> (qasur më 2 shtator 2020).

66 Këshilli i Evropës, Konventa evropiane për transferimin e procedurave në rastet penale, Strasburg, 15.V.1972, ETS Nr.73 në dispozicion në: <https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list/-/conventions/treaty/073> (qasur më 2 korrik 2020).

67 Këshilli i Evropës, Konventa për pastrimin, depistimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e produkteve të krimit, Strasburg, 8.XI.1990, ETS Nr.141 në dispozicion në: <https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list/-/conventions/treaty/141> (qasur më 2 korrik 2020).

të përbashkët me fokus në nxjerrjen e legjislacionit adekuat dhe promovimin e bashkëpunimit ndërkombëtar për të mbrojtur qytetarët nga krimi kibernetik.<sup>68</sup>

#### 4.2.1. Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Terrorizmin

Dispozita thelbësore që rregullon veprimet në lidhje me arrestimin dhe ndalimin është neni 5 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ)<sup>69</sup>, i cili mbron lirinë dhe sigurinë e personit. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) ka theksuar vazhdimisht se është një nga parimet themelore të një shoqërie demokratike që shteti duhet t'a respektoj rreptësisht sundimin e ligjit kurdo që ndërhyt në të drejtën e lirisë personale. E drejta ndërkombëtare e bën të qartë se veprimtaria e shtetit kundër terrorizmit duhet të ndodhë brenda kornizës së së drejtës ndërkombëtare.

Neni 3 i KEDNJ ndalon torturën ose trajtimin çnjerëzor ose poshtërues. Për parandalimin e torturës dhe keqtrajtimin, përfaqësuesit e Mekanizmit Parandalues kundër Torturës të Kosovës rregullisht i vizitojnë vendet e mbajtjes në Kosovë.<sup>70</sup> Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin ose Ndëshkimit Çnjerëzor ose Poshtërues ka bërë rekomandime në lidhje me trajtimin e atyre që janë në mbajtje në Kosovë.<sup>71</sup> Me sa duket se zbatimi është në vazhdim e sipër. Mirëpo, Komisioni Evropian konstatoi se sistemi i burgjeve përputhet në përgjithësi me rregullat standarde minimale të OKB-së për trajtimin e të burgosurve dhe me rregullat evropiane të burgjeve.<sup>72</sup> Përkundër kesaj ai zbuloi se kishte shumë dallime në këto kushte dhe kishte nevojë për uniformitet në krijimin e kushteve minimale që janë duke u plotësuar.

Neni 9 i KEDNJ thotë: *“Çdokush ka të drejtë të ... të shfaqë fenë ose besimin e tij, në nëpërmjet kultit, mësimdhënies, praktikave dhe kryerjes së riteve”*.<sup>73</sup> Liria e shfaqjes së fesë ose besimeve të dikujt nuk mund t'i nënshtrohet kufizimeve të tjera, përveç atyre të *“parashikuara nga ligji dhe që përbëjnë masa të nevojshme në një shoqëri demokratike në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, të shëndetit ose të moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të të tjerëve”*.<sup>74</sup>

Neni 9 i KEDNJ mbron lirinë e personit për të shfaqur fenë e tij/saj. Liria e shfaqjes së fesë ose besimeve të dikujt nuk mund t'i nënshtrohet kufizimeve të tjera, përveç atyre të *“parashikuara nga ligji” dhe “të nevojshme në një shoqëri demokratike në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, të shëndetit ose të moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të të tjerëve”*. Në rastin *Eweida kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka theksuar se neni 9 është një nga *“themelet e shoqërisë*

68 Këshilli i Evropës, Konventa për krimin kibernetik, Budapest, 23.XI.2001, ETS Nr.185. E qasshme në <https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list/-/conventions/treaty/185> (qasur më 2 shtator 2020).

69 Neni 5 (E drejta për liri dhe siguri), Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ).

70 Neni 17, paragrafi 2.2, Ligji nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit e Përcakton Institucionin e Avokatit të Popullit të Kosovës si Mekanizmin Kosovar për Parandalimin e Torturës.

71 Raporti i KE-së për Kosovën *fn. 40* në faqe 30.

72 *Po aty*.

73 *Po aty*. Neni 9.1 (Liria e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë).

74 *Po aty*. Neni 9.2 (Liria e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë).

*demokratike' sipas kuptimit të [Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut] ... Pluralizmi si pjesë e pandashme e shoqërisë demokratike, i fituar me mund përgjatë shekujve, varet nga ai.*<sup>75</sup>

GJEDNJ e ka paraparë të drejtën për respektimin e jetës private dhe familjare. Është e drejtë e kualifikuar<sup>76</sup>. Më tej, GJEDNJ e mbron të drejtën e lirisë së shprehjes<sup>77</sup>. Përsëri, është e kualifikuar. Me fjalë të tjera, ushtrimi i këtyre lirive, duke qenë se ato mbartin me vete detyra dhe përgjegjësi, mund t'i nënshtrohet formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose gjobave që parashihen me ligj dhe janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike, për parandalimin e trazirave ose krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose moralit, për mbrojtjen e reputacionit ose të drejtave të tjerëve, për parandalimin e zbulimit të informacionit të marrë në mirëbesim, ose për ruajtjen e autoritetit dhe paanshmërisë së gjyqësorit<sup>78</sup>. Megjithatë, këto kufizime duhet të jenë brenda kornizës ligjore dhe të jenë proporcionale.

Gjatë hulumtimit, ne kemi gjetur se nuk duket të ketë konsideratë specifike brenda institucioneve apo nga avokatët për shkallën e ndërhyrjes në të drejtat nga neni 8 dhe 10 i KEDNJ-së. Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën 2020 në analizën e tij të pajtueshmërisë vë në dukje se liria e shprehjes zë vend në Kushtetutën e Kosovës dhe se shoqëria në Kosovë është pluraliste, por paralajmëron për nevojën për ta ruajtur këtë mbështetje; veçanërisht duke iu referuar mbështetjes së gazetarëve. Një rekomandim specifik është përmirësimi i kësaj "përmes bashkëpunimit më të mirë ndërinstytucional", që është temë e cila përshkon Raportin e Kosovës.<sup>79</sup>

Përmbledhja sistematike e informacionit personal nga autoritetet publike e aktivizon nenin 8 të KEDNJ.<sup>80</sup> Bisedat telefonike dhe posta elektronike (emailt) bien në përkufizimin e "jetës private" dhe "korrespondencës" që mbrohen nga neni 8 i KEDNJ-së.<sup>81</sup>

Personi do të pësojë ndërhyrje në të drejtat e tij nga neni 8 jo vetëm nëpërmjet mbledhjes së përmbajtjes së komunikimeve të tij, por edhe nëpërmjet mbledhjes së të dhënave në lidhje me komunikimet e tij dhe ruajtjes së këtyre të dhënave për qasje nga autoritetet publike.<sup>82</sup>

---

75 *Eweida kundër Mbretërisë së Bashkuar* (2013) 57 EHRR 9, §79.

76 *Po aty*. Neni 8 (E drejta për respektimin e të drejtës private dhe familjare).

77 *Po aty*. Neni 10 (Liria e shprehjes).

78 *Po aty*. Neni 10,2.

79 Dokumenti i punës së stafit të Komisionit - Raporti për Kosovën 2020, Bruksel, 06.10.2020 SWD (2020) 356 final.

[https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/kosovo\\_report\\_2020.pdf](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/kosovo_report_2020.pdf) (qasur më 4 shkurt 2021)

80 Shih, mes autoriteteve tjera, *Rotaru kundër Rumanisë* 8 BHRC 449; *Shimovolos kundër Rusisë* 31 BHRC 506, në paragrafin 65; *PG dhe JH kundër Mbretërisë së Bashkuar* (2008) 46 EHRR 51, në paragrafin 57

81 Shih, si shembull, *Malone kundër Mbretërisë së Bashkuar* (1985) 7 EHRR 14, në paragrafin 64, *Weber kundër Gjermanisë* (2008) 46 EHRR SE5, në paragrafin 77; *Liberty kundër Mbretërisë së Bashkuar* (2009) 48 EHRR 1; *Kennedy kundër Mbretërisë së Bashkuar* (2011) 52 EHRR 4, në paragrafin 118.

82 *Malone kundër Mbretërisë së Bashkuar* (1985) 7 EHRR 14.



Kërcënimi i përgjimit sekret patjetër godet edhe lirinë e komunikimit të përdoruesve të shërbimeve të telekomunikacionit, gjë që angazhon nenin 10 të KEDNJ-së.<sup>83</sup>

Sipas barazisë së arsytimit, çdo ndërhyrje dhe ruajtje e historisë së internetit të individëve, përdorimit të internetit ose komunikimit të internetit angazhon nenet 8(1) dhe 10(1) të KEDNJ-së. Kjo për shkak se komunikimet dhe/ose të dhënat e tilla janë personale dhe private. Ata mund të zbulojnë materiale shumë personale për jetën e tyre familjare, seksualitetin, bindjet politike ose aktivitetin gjyqësor. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut është shprehur se nuk ka nevojë që informacionet që rrjedhin nga monitorimi i përdorimit të internetit të trajtohen ndryshe nga thirrjet telefonike për qëllime të nenit 8.<sup>84</sup>

E identifikuar përmes intervistave për qëllim të këtij raporti, ekziston një nevojë për ekzaminim më të madh nëse metodat e përgjimit të fshehtë të përdorura gjatë fazës së hetimit janë duke përmbushur këto standarde, me kontrolle dhe garanci adekuate në secilën fazë. Gjithashtu, ruajtja e materialit personal dhe kohëzgjatja e ruajtjes nuk duket se ka garanci praktike për të siguruar që ajo është në përputhje me nenin 8 të KEDNJ.

Neni 6 i KEDNJ-së i garanton një personi të drejtën për gjykim të drejtë. Shumë nga garancitë janë pasqyruar në KPP. Megjithatë, të drejtat për qasje të papenguar në një avokat dhe komunikimin privat ndërmjet klientit dhe avokatit duhet të mbahen nën shqyrtim; kjo ishte tema që doli nga intervista jonë.

---

83 *Weber kundër Gjermanisë* (2008) 46 EHRR SE5 në paragrafët 144-145.

84 *Copland kundër Mbretërisë së Bashkuar*, (2007) 45 EHRR 37, në paragrafin 41.

## 5. RASTET E LIDHURA ME TERRORIZMIN NË KOSOVË 2018 - 2020

Nga dhjetori 2020 deri në janar 2021, janë realizuar intervista cilësore me përfaqësues të sistemit të drejtësisë penale në Kosovë, të përfshirë në trajtimin e rasteve të terrorizmit. Kjo ka përfshirë intervista ndërmjet hartuesve dhe gjyqtarëve të Gjykatës Themelore të Prishtinës; gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit; prokurorëve nga Prokuroria Speciale; pjesëtarëve të lartë të PK-së; përfaqësuesve të lartë nga NjIF; avokatëve mbrojtës që përfaqësojnë individë të akuzuar për vepra të terrorizmit.

Përveç kësaj, ndërmjet viteve 2018 dhe 2020, monitoruesit e gjykimeve të OSBE-së vëzhguan gjithsej 220 seanca gjyqësore në 54 raste.<sup>85</sup> Ekipi analizoi në mënyrë kritike të dhënat sasiore të marra nga monitoruesit e gjykimeve, për të mbështetur dhe informuar gjetjet në kuadër të këtij raporti. OSBE-ja ka monitoruar rastet e terrorizmit që nga faza fillestare e shqyrtimit deri në zgjidhjen përfundimtare të rasteve dhe rigjykimet, si rezultat i mjeteve juridike të paraqitura në Gjykatën e Apelit. Duke i kushtuar vëmendje të veçantë përputhshmërisë së gjyqësorit me të drejtat e gjykimit të drejtë, siç është e drejta për t'u dëgjuar nga një gjykatë kompetente, e pavarur dhe e paanshme; e drejta për dëgjim publik; e drejta për gjykim brenda një kohe të arsyeshme; e drejta për mbrojtje efektive; e drejta për përkthim të procedurave aty ku është e nevojshme, si dhe të drejtat e ndërlidhura, të garantuara si nga korniza ligjore e Kosovës ashtu edhe nga ajo ndërkombëtare, siç është përvijuar tashmë më lartë.

Vëzhgimet dhe gjetjet kryesore janë paraqitur përmes një vlerësimi sasior të fokusuar në të dhëna të trendeve të ndjekjeve penale mes viteve 2018 dhe 2020, të ndërlidhura me nxjerrjen e temave kryesore nga studimet cilësore të rasteve dhe shënimet e intervistat e monitorimit të gjykimeve për të njëjtën periudhë kohore për të demonstruar nivelin e performancës.

### 5.1. Gjetjet Kryesore

Institucionet e drejtësisë penale në Kosovë udhëhiqen nga një kornizë ligjore e cila garanton gjerësisht mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në përputhje me standardet evropiane. Hyrja në fuqi e Kodit Penal të reviduar në vitin 2019 çoi në progres të rëndësishëm, duke e rritur saktësimin e veprave penale dhe duke zgjeruar spektrin e veprave të mundshme.

Megjithatë, zbatimi i legjislacionit dhe strategjive për të drejtat e njeriut shpesh dëmtohet nga burimet e pamjaftueshme financiare dhe të tjera, veçanërisht në nivel lokal, prioritetet e kufizuara politike dhe mungesa e koordinimit. Mekanizmat ekzistues për bashkërendimin dhe zbatimin e të drejtave të njeriut brenda sistemit të drejtësisë penale janë joefektivë dhe kjo shfaqet në ndjekjen penale të rasteve të lidhura me terrorizmin në tre mënyra specifike:

---

85 Këtu përfshihen si rastet e trashëguara ashtu edhe rastet e reja.



- i. *Vazhdon* të ketë mungesë e qartësisë së provave që mbështesin ngritjen e aktakuzave, me qartësi të pamjaftueshme se cilat elemente të veprës penale janë duke u zbatuar sipas cilit Kod (KP 2012/KP 2019), dhe preferencë për nenin 143, KP 2012 (në lidhje me pjesëmarrja), mbi dhe përtej të gjitha neneve tjera brenda Kodit;
- ii. *Paraburgimi* caktohet në mënyrë rutinore përpara se të dorëzohet ndonjë provë në bazë të aktakuzës, ku zbulimet që i dorëzohen mbrojtjes në fazat e hershme janë pamjaftueshëm të detajuara për ta arsyetuar paraburgimin e të akuzuarit;
- iii. *Aktgjytimeve* të dhëna për shpalljen fajtor dhe dënimin u mungon transparenca dhe arsyetimi i hollësishëm mbi elementet e veprës penale dhe barra e provës që është zbatuar, analiza e provave dhe veçoritë e të pandehurit. Dënimeve, veçanërisht kur janë me kusht, u mungon saktësimi në referimet në rastin kundër të pandehurit dhe janë shumë të përgjithshme në natyrë.

Temat kryesore të mëposhtme kanë buruar nga intervistat dhe të dhënat e pranuar:

- Përkundër shtimit të gamës dhe veçorive të veprave terroriste ndërmjet Kodeve Penale të vitit 2012 dhe 2019, nenet mbi *pjesëmarrjen dhe organizimin* (nenet 143/136) janë të stërpërdorura dhe të përfaqësuara në aktakuzat e ngritura nga prokuroria gjatë dy viteve të fundit, në rrethana kur akuza tjera ose alternative mund të kenë qenë më të përshtatshme;
- Financimi i terrorizmit nuk është ndjekur penalisht sa duhet. Ka pasur vetëm një dënim për financim të terrorizmit në vitin 2019, pavarësisht se atë vit NjJF ka referuar 16 raste në polici;<sup>86</sup>
- Në fazën e hetimit, duket se i kushtohet pak ose aspak konsideratë e regjistruar ushtrimit të baraspeshimit të të drejtave gjatë përdorimit të metodave të fshehta të inteligjencës;
- Duket se ka mangësi të evidencës të kontroleve nga avokatët se ishin bërë kërkesat e duhura për të autorizuar aktivitete të caktuara hetimore;
- Paraburgimi ushtrohet në mënyrë rutinore veçanërisht për të dyshuarit meshkuj (ku të dyshuarat femra vendosen në arrest shtëpiak), kur mungon baza provuese për të arsyetuar privimin e lirisë;
- Është raportuar se, në fazën e procedurës paraprake, zbulimi i provave ndaj mbrojtjes është i mangët;
- Në fazën e procedurës paraprake, kërkesat nga mbrojtja për zbulim duket të jenë të mangëta; të dhënat e monitorimit të gjytimeve tregojnë se mbrojtja rrallëherë i drejtohet gjykatës për të detyruar prokurorin që të bëjë zbulime shtesë.
- Është raportuar se ka një ndërrim të madh të përfaqësimit mbrojtës në gjykatat themelore duke ndikuar negativisht në përshtatshmërinë e përfaqësimit;

---

86 Statistikat e Njësisë së Inteligjencës Financiare të Kosovës.

- Pranimi i fajësisë shpesh bëhet nga gratë edhe në rastet kur nuk ka prova të mjaftueshme për veprat e kryera dhe me duke nënkuptuar se do të ofrohet dënim me kusht në këmbim të pranimit të fajësisë;<sup>87</sup>
- Është raportuar se aktgjykimet dënuese nga gjyqtarët në Gjykatën Themelore shpesh prishen nga Gjykata e Apelit për shkak të mungesës së provave; kthehen në Gjykatën Themelore dhe më pas i pandehuri shpallet i pafajshëm;<sup>88</sup>
- Mungesa e përvojës gjyqësore në lidhje me pranueshmërinë dhe peshën e provave të palëve të treta rrezikon të ulë pa dashje barrën e provës;
- Aktgjykimeve të dhëna për shpalljen fajtor dhe dënimin e të pandehurve u mungon arsyetimi i hollësishëm për testet dhe barrën që zbatohet në lidhje me nenet e veçanta, me analiza të pamjaftueshme të provave;
- Dënimeve, veçanërisht kur janë me kusht, u mungon saktësia në referimet në rastin kundër të pandehurit dhe janë shumë të përgjithshme për nga natyra;
- Dënimeve u mungon arsyetimi adekuat për të vlerësuar barazinë e trajtimit të bashkëpandehurve (rrethanat e të pandehurve dhe dallimet në nivelin e shkëlqes nuk janë analizuar në mënyrë transparente);
- Duket se ka pak ose aspak shfrytëzim të mundësive për mbledhjen e inteligjencës nga të dyshuarit ose të pandehurit e dënuar;
- Ekziston konsideratë e pamjaftueshme e lidhjeve ndërmjet provave në raste të ndryshme dhe ndërmjet të pandehurve të ndryshëm dhe bashkimit të të pandehurve individualë në një gjykim;
- Krijimi i Prokurorisë Speciale duket se ka ndikuar pozitivisht në zvogëlimin e numrit të seancave të humbura;
- Krijimi i Prokurorisë Speciale dhe Gjykatës e ka lehtësuar detyrën e policisë në parashtrimin e kërkesave në gjykatë pasi që nuk ka nevojë për të udhëtuar jashtë Prishtinës dhe prokurorët specialë janë lehtësisht të identifikueshëm.
- Marrëdhënia mes institucioneve është e mirë; veçanërisht mes policisë dhe NjIF-it.

### 5.1.1. Diskutim rreth gjetjeve

Në vitin 2020 pati rritje dramatike të numrit të rasteve të terrorizmit që u ndoqën penalisht në Kosovë; personat e kthyer dhe të riatdhesuar që kishin jetuar në zonat e konfliktit në Siri u ndoqën penalisht kryesisht me kthimin e tyre gjatë këtij viti dhe rastet e tyre ende po procedohen në sistemin e drejtësisë penale.<sup>89</sup> Kjo rritje shumë e papritur

87 Në vitin 2020, OSBE ka monitoruar 21 raste në të cilat janë shpallur aktgjykime. Në këto raste janë përfshirë 29 të pandehur, gjashtë burra dhe 23 gra. Nga 23 gra, 19 (83 për qind) e kanë pranuar fajësinë. Nga 6 burrat, njeri (17 për qind) e ka pranuar fajësinë. Analiza e dënimeve të shqiptuara për vepra terrorizmi në vitin 2020 tregon se të gjitha të pandehurat gra që e pranojnë fajësinë marrin dënime me burgim me kusht.

88 Shih gjithashtu gjetjet dhe rekomandimet e raportit të monitorimit të drejtësisë të Misionit të BE-së për Sundim të Ligjit, shtator 2019 – Mesi i Marsit 2020 (tetor 2020) në faqen 12. Në dispozicion në [https://www.eulex-kosovo.eu/eul/repository/docs/19102020\\_EU%20Rule%20of%20Law%20Mission%20Justice%20\\_EN.pdf](https://www.eulex-kosovo.eu/eul/repository/docs/19102020_EU%20Rule%20of%20Law%20Mission%20Justice%20_EN.pdf) (qasur më 5 dhjetor 2021).

89 Ky numër përfshin katër burra, 32 gra dhe 74 fëmijë, përfshirë nëntë jetimë (Raporti i Policisë së Kosovës, gusht 2020).

e rasteve të terrorizmit sfidoi njësinë e sapoformuar të prokurorisë dhe testoi aftësitë e saj.

Menjëherë para kësaj, në vitin 2018, dhe deri më sot, rastet e terrorizmit brenda Kosovës ishin relativisht të ulëta. Hetimet dhe ndjekjet e policisë, nga 1 janari 2018 e deri më sot, janë gjithashtu relativisht të pakta, me vetëm 19 raste të terrorizmit brenda Kosovës që janë iniciuar në vitin 2018.<sup>90</sup> Në këtë kontekst, policia ka arrestuar<sup>91</sup> gjithsej 14 të dyshuar,<sup>92</sup> 12 burra dhe dy gra. Moshë e të dyshuarve varion nga 19 deri në 52 vjeç.

### Numri i rasteve që lidhen me terrorizmin të monitoruara në gjykatat e Kosovës




Figura 3: Numri i rasteve të terrorizmit të monitoruara nga OSBE-ja në gjykatat e Kosovës

Që nga prilli 2019, 110 persona janë riatdhesuar në Kosovë me ndihmën e Shteteve të Bashkuara (SHBA) nga zona e konfliktit në Siri.<sup>93</sup> Të 32 gratë që janë kthyer nga zonat e konfliktit në Siri janë shqiptare të Kosovës me moshë nga 18 deri në 50 vjeç.

Reagimi i menjëhershëm i autoriteteve kosovare ishte vendosja e grave në arrest shtëpiak, ndërsa burrave në paraburgim.<sup>94</sup>

#### 5.1.2. Paraburgimi

Derisa që nga dhjetori 2020, nuk u regjistrua asnjë ankesë zyrtare kundër Drejtorisë së Policisë Kundër Terrorizmit në lidhje me shkeljet e të drejtave në fazën para gjyqimit, ishte e qartë nga hulumtimi cilësor i kryer se në shumë raste individët po mbaheshin në paraburgim dhe prova minimale po i zbuloheshin të pandehurve ose avokatëve të tyre.

90 13 raste kanë të bëjnë me Kodin Penal Nr. 04/L-82, të 13 korrikut 2012, nenet 136 – 145; ndërsa gjashtë raste të tjera lidhen me Kodin e ri Penal Nr.06/L074 të 14 janarit 2019, nenet 129 – 139.

91 Neni 72, Kodi i Procedurës Penale, E drejta e Policisë për ndalim të shkurtër.

92 12 të dyshuar, 11 burra dhe një grua janë arrestuar nën dyshimin për terrorizëm nga nenet 136 – 145, Kodi Penal Nr. 04/L-82, 13 korrik 2012; ndërsa dy të dyshuar të tjerë, një burrë dhe një grua, nën dyshimin për terrorizëm, nga neni 129 – 139 – Kodi Penal – Nr.06/L074 i 14 janarit 2019.

93 Katër burra, 32 gra dhe 74 fëmijë, përfshirë nëntë jetimë.

94 Neni 183, Kodi i Procedurës Penale Nr. 04/L-123.

Në maj të vitit 2019, iu raportua OSBE-së se mes datës 20 dhe 26 prill 2019,<sup>95</sup> gjyqtari i procedurës paraprake i Departamentit Special në Gjykatën Themelore të Prishtinës kishte aprovuar kërkesat e prokurorisë dhe kishte lëshuar 31 vendime për arrest shtëpiak ndaj 31 femrave të dyshuara, duke përfshirë dy të mitura, dhe katër vendime për paraburgim ndaj katër të dyshuarve meshkuj, duke përfshirë një të mitur. Akuzat e pretenduara ishin organizimi dhe pjesëmarrja në grup terrorist,<sup>96</sup> dhe anëtarësimi ose pjesëmarrja në ushtri, polici, organizatë paraushtarake të huaj, në grup ose individualisht, jashtë Kosovës.<sup>97</sup>


### 5.1.3. Aktakuzat dhe përshtatshmëria e akuzave

Në vitin 2018, monitoruesit e gjykimeve të OSBE-së regjistruan nisjen e gjashtë rasteve të reja të lidhura me terrorizmin,<sup>98</sup> ku prokuroria ngrii aktakuza ndaj 21 personave (19 meshkuj dhe dy femra).

Në vitin 2019 janë monitoruar 11 raste të reja të lidhura me terrorizmin, ku janë përfshirë pesë burra dhe gjashtë gra.<sup>99</sup>

Në vitin 2020 janë monitoruar 11 raste të reja të reja, ku janë përfshirë gjashtë burra dhe tetë gra.<sup>100</sup>

**Burra dhe gra të akuzuar për vepra penale të terrorizmit në rastet pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë gjatë periudhës 2018 - 2020**



95 Më 08 maj 2019, OSBE-ja organizoi takim me përfaqësuesit e Departamenteve Speciale në Gjykatën Themelore të Prishtinës për të marrë përditësime me qëllim të monitorimit të mëtejshëm të statusit dhe fazës procedurale të gjyqimit të grave të riadhesuara. Ky informacion ishte pranuar gjatë atij takimi.

96 Neni 143 (2), Kodi Penal, Nr. 04/L-82, 13 korrik 2012.

97 Neni 3 (3), Ligji Nr. 05/L -002, për ndalimin e bashkimit në konfliktet e armatosura jashtë territorit shtetëror, 2 Prill 2015.

98 Përveç këtij numri, 13 raste janë trashëguar nga viti(et) paraprake.

99 Përveç këtij numri, nëntë raste janë trashëguar nga viti(et) paraprake.

100 Përveç këtij numri, 21 raste janë trashëguar nga viti(et) paraprake.

Figura 4: Burra dhe gra të akuzuar për vepra terrorizmi në periudhën 2018-2020<sup>101</sup>

Ishte vërejtur tendencë e dukshme që të pandehurit të akuzohen sipas nenit 143 të Kodit Penal të vitit 2012 për veprën specifike të “organizimit dhe pjesëmarrjes në grup terrorist”.<sup>102</sup>

**Krahasimi ndërmjet numrit të të pandehurve të akuzuar për vepra të terrorizmit sipas aktakuzave të ngritura pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë gjatë viteve 2018, 2019 dhe 2020**




Figura 5: Krahasimi mes numrit të të pandehurve të akuzuar për vepra terrorizmi në vitet 2018, 2019 dhe 2020<sup>103</sup>

101 Shifrat e marra nga shkrimorja e gjykatës.

102 Neni 136 “Kryerja e veprës penale të terrorizmit”; Neni 137 “Ndihma në kryerjen e terrorizmit”; Neni 138 “Lehtësimi në kryerjen e terrorizmit”; Neni 139 “Rekrutimi për terrorizëm”; Neni 140 “Trajnimi për terrorizëm”; Neni 141 “Shtytja për kryerjen e veprave terroriste”; Neni 142 “Fshehja ose moslajmërimi i terroristëve dhe grupeve terroriste”; Neni 143 “Organizimi dhe pjesëmarrja në grup terrorist”; Neni 144 “Përgatitja e veprave terroriste ose veprave penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës”, Kodi Penal, Nr. 04/L-82, 13 korrik 2012.

103 Shifrat e marra nga shkrimorja e gjykatës.

## Numri i të pandehurve të akuzuar me vepra që lidhen me terrorizmin në aktakuzat e ngritura në Gjykatën Themelore në Prishtinë gjatë vitit 2018




Figura 6: Numri i të pandehurve të akuzuar për vepra të lidhura me terrorizmin në aktakuzat e ngritura në Gjykatën Themelore të Prishtinës gjatë vitit 2018<sup>104</sup>

Në vitin 2018, shumica e të pandehurve u akuzuan për përgatitje të veprave terroriste (nëntë burra dhe dy gra) ose pjesëmarrje dhe organizim në grup terrorist (shtatë të pandehur, të gjithë burra). Në vitin 2018 gjithashtu pati dy të pandehur të akuzuar për bashkim ose pjesëmarrje në një konflikt të armatosur jashtë Kosovës.<sup>105</sup>

Ligji për ndalimin e bashkimit në konflikte të armatosura jashtë territorit shtetëror hyri në fuqi në vitin 2015 për të adresuar shqetësimet në lidhje me numrin e njerëzve që ishin larguar nga Kosova për të luftuar me 'Shtetin Islamik'.<sup>106</sup> Megjithatë, gjetjet e këtij raporti sugjerojnë që prokurorët vazhdojnë ta përdorin dispozitën më pak specifike të 'organizimit dhe pjesëmarrjes në një grup terrorist' kur ndjekin penalisht personat e kthyer ose të riatdhesuar nga zonat e konfliktit jashtë Kosovës.<sup>107</sup> Një pasojë e dukshme e kësaj preference për akuzimin e luftëtarëve të kthyer sipas nenit 143 të Kodit Penal është se dënimi maksimal sipas kësaj dispozite është 10 vite burgim, ndërsa dënimi maksimal sipas seksioneve përkatëse të nenit 3, Ligjit për ndalimin e bashkimit në konflikte të armatosura jashtë territorit shtetëror është 15 vite burgim.

104 Shifrat e marra nga shkrimorja e gjykatës.

105 Ligji Nr. 05/L-002 "Për Ndalimin e bashkimit në konflikte të armatosura jashtë territorit shtetëror", neni 3, "Bashkimi ose pjesëmarrja në ushtri ose polici të huaj, formacione të huaja paraushtarake dhe parapolicore, në grupe të organizuara ose individualisht, jashtë territorit të Republika e Kosovës".

106 Shih <https://balkaninsight.com/2015/03/13/kosovo-law-to-punish-fighting-in-foreign-conflicts/> (e qasur më 1 dhjetor 2021).

107 Kodi Nr. 04/L-082 Kodi Penal i Kosovës 2012, neni 143, "Organizimi dhe pjesëmarrja në grup terrorist".

### Numri i të pandehurve të akuzuar për vepra që lidhen me terrorizmin në aktakuzat e ngritura pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë gjatë vitit 2019




Figura 7: Numri i të pandehurve të akuzuar për vepra të lidhura me terrorizmin në aktakuzat e ngritura në Gjykatën Themelore të Prishtinës gjatë vitit 2019<sup>108</sup>

Në vitin 2019, tre të pandehur u akuzuan në bazë të nenit 3 të Ligjit për ndalimin e bashkimit në konflikte të armatosura jashtë territorit shtetëror.<sup>109</sup> dhe tre të pandehur janë përballur me akuza për veprën penale të shtytjes për të kryer veprë terroriste.<sup>110</sup> Shumica e të pandehurve (katër meshkuj dhe 14 femra) u akuzuan për pjesëmarrje dhe organizim në një grup terrorist.

Duket se prokuroritë nuk kanë kaluar tërësisht në Kodin Penal të vitit 2019 për shkak të rasteve të pazgjidhura, përfshirë ato me personat e riatdhesuar të vitit 2019. Parashikohet që kjo të zgjidhet vetë me kalimin e kohës, por duhet bërë përpjekje e vetëdijshme për të qartësuar përdorimin e kodeve penale dhe për të kaluar pa u vërejtur në akuza nga gama e gjerë e veprave penale sipas Kodit Penal të vitit 2019, aty ku është e përshtatshme.

108 Shifrat e marra nga shkrimorja e gjykatës.

109 Ligji Nr. 05/L-002, për ndalimin e bashkimit në konflikte të armatosura jashtë territorit shtetëror, 2 Prill 2015.

110 Po aty. Neni 134.

## Numri i të pandehurve të akuzuar për vepra që lidhen me terrorizmin në aktakuzat e ngritura pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë gjatë vitit 2020




Figura 8: Numri i të pandehurve të akuzuar për vepra të lidhura me terrorizmin në aktakuzat e ngritura në Gjykatën Themelore të Prishtinës gjatë vitit 2020<sup>111</sup>

### 5.1.4. Financimi i Terrorizmit

Financimi i terrorizmit është penalizuar si vepër më vete në nenin 131 të KP të vitit 2019 në kuadër të lehtësimit të terrorizmit. Për më tepër, dispozitat e mëposhtme të KP të vitit 2019 janë të zbatueshme për veprën penale të financimit të terrorizmit: Neni 138, (Përgatitja e veprave terroriste ose veprave penale); Neni 130, (Ndihma në kryerjen e terrorizmit); dhe neni 132 (Rekrutimi për terrorizëm si dhe i financuesve të terrorizmit). Përkufizimi i "terrorizmit, aktit terrorist ose veprës terroriste" është dhënë në nenin 128 të KP 2019.

Ligji për Ndalimin e Bashkimit me Konfliktet e Armatosura Jashtë Territorit Shtetëror gjithashtu krijon një vepër të veçantë për, "kushdo në çfarëdo mënyre të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, ofron, kërkon, mbledh ose fsheh fonde ose mjete të tjera materiale me dashje, me vetëdije ose [ku] ka arsye të arsyeshme për të besuar se do të përdoret

<sup>111</sup> Shifrat e marra nga shkrimorja e gjykatës.



tërësisht ose pjesërisht” për kryerjen e një veprë penale sipas paragrafit 1 të nenit, p.sh. organizimi, rekrutimi, udhëheqja ose trajnimi i njerëzve për t’iu bashkuar konflikteve jashtë Kosovës.<sup>112</sup>

Përkundër kapaciteteve të përgjithshme të autoriteteve hetuese të Kosovës për të ndërmarrë hetime financiare veçanërisht në rastet e lidhura me terrorizmin, nuk u krye asnjë ndjekje penale në lidhje me veprat penale të financimit të terrorizmit në një numër rastesh ku aspektet e financimit dukej se ishin identifikuar qartë. Fokus i mëtejshëm duhet t’i kushtohet ndjekjes penale të financimit të terrorizmit si vepër e vetme. Për periudhën mes viteve 2018 dhe 2020, ka pasur vetëm një dënim përfundimtar për financimin e terrorizmit nga gjithsej 16 raste të referuara në polici nga NjIF.<sup>113</sup>

Korniza legislative për ndjekjen penale të aspekteve të ndryshme të veprës penale të financimit të terrorizmit ka mangësi dhe duhet të qartësohet dhe forcohet. Pavarësisht të kuptuarit, deri në një masë, të rreziqeve të financimit të terrorizmit në Kosovë dhe rajon dhe disa masave lehtësuese, autoritetet nuk kanë zbatuar një sistem gjithëpërfshirës të sanksioneve financiare të synuara. Kjo mungesë e mbikëqyrjes strategjike dhe komunikimit joefektiv përkeqësohet nga mungesa e një kuadri ligjor solid për sanksionet e synuara. Institucionet e Kosovës po kërkojnë ta trajtojnë këtë fushë me sjelljen e një projektligji, duke ulur barrën e provës për të lejuar shqiptimin e urdhrave të ngrirjes në rastet kur mund të dëshmohet "dyshimi i arsyeshëm", në vend të "bazës së arsyeshme për të besuar" që kërkohet aktualisht sipas nenit 131 të KP të vitit 2019.

Marrëdhënia e ndarë midis hetimeve për financimin e terrorizmit dhe pastrimit të parave është një tjetër burim shqetësimi. Ndonëse mund të jenë vepra të ndryshme, sigurisht që ka vend për mbivendosje dhe kërkesë për komunikim më të mirë ndërmjet dy njësive hetuese. Është përcaktuar se ka mungesë të një qasjeje të shënjestruar ndaj organizatave jofitimprurëse (OJF), nga njëra anë, nga mangësitë në vlerësimin e rreziqeve të financimit të terrorizmit në këtë sektor, por kjo gjithashtu rrjedh edhe nga përfshirja e OJF-ve të caktuara në ekonominë joformale dhe evazionin fiskal.

Në periudhën raportuese ndërmjet viteve 2018 dhe 2020, asnjë person i vetëm nuk është akuzuar dhe dënuar me sukses për nenin 57 të Ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit<sup>114</sup>. Sipas Raportit të Progresit të BE-së për Kosovën 2019, organet e zbatimit të ligjit dhe institucionet gjyqësore në Kosovë “vazhdojnë t’i përgjigjen me forcë terrorizmit”, megjithatë “lufta kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit nuk është mjaft efektive për të prodhuar rezultate bindëse”.<sup>115</sup> Gjetjet e Këshillit të Evropës të vitit 2018<sup>116</sup> parashohin se nevojiten trajnime shtesë, veçanërisht në sistemin gjyqësor lidhur me fokusin specifik në hetimin financiar

112 Ligji Nr. 05/L -002, për ndalimin e bashkimit në konflikte të armatosura jashtë territorit shtetëror, neni 3 par 2

113 Intervistë me NjIF, 11 janar 2021.

114 Ligji nr. 05/L-096 për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit, 15 qershor 2016.

115 Dokument Pune i Stafit të Komisionit, Raporti i vitit 2019 për Kosovën, Komisioni Evropian, Bruksel, 29.5.2019.

SWD (2019) 216 final, fq. 38. Në dispozicion në <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-kosovo-report.pdf>

116 Raporti i Vlerësimit për pajtueshmërinë e Kosovës me standardet ndërkombëtare kundër pastrimit të parave dhe luftimit të financimit të terrorizmit, qershor 2018 COE [Projekti kundër krimit ekonomik në Kosovë (PECK II)], fq. 75. Në dispozicion në <https://rm.coe.int/assessment-report-on-compliance-of-kosovo-with-international-antimone/16809381e1>

dhe ndjekjen penale të financimit të terrorizmit, duke përfshirë financimin e luftëtarëve të huaj dhe personave vendas që bashkohen me grupet paraushtarake ose terroriste në zonat e konfliktit. Në takimet me anëtarët e NjIF-it në dhjetor të vitit 2020 dhe janar 2021, personeli përsëriti nevojën për trajnime mbi strategjinë specifike dhe ligjin për financimin e terrorizmit si brenda njësisë së tyre, brenda Prokurorisë Speciale në Prishtinë, ashtu edhe për gjyqësorin.

Përfaqësuesit e NjIF konsideruan se mungesa e trajnimit të specializuar në ndjekjen penale të financimit të terrorizmit, mungesa e personelit dhe mungesa e një strategjie gjithëpërfshirëse është përgjegjëse për numrin jashtëzakonisht të ulët të ndjekjeve penale në këtë fushë. Kishte kallëzime për 16 raste të financimit të terrorizmit të referuara në polici, por vetëm një rast i vetëm çoi në dënim,<sup>117</sup> mungesa e vetëbesimit në ndjekjen penale të terrorizmit financiar brenda institucioneve të drejtësisë penale të Kosovës, duhet të adresohet.

Kështu ka ndodhur pavarësisht se stafi i NjIF-it ka raportuar për nivele të larta të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të Kosovës dhe ka dhënë shembuj të bashkëpunimit të suksesshëm ndërkombëtar.

### 5.1.5. Gjykimet

Është vënë re se gjykatat në përgjithësi e kanë respektuar dhe ishin të vetëdijshëm për standardet e të drejtave të gjykimet të drejtë, por vunë re probleme në lidhje me numrin e seancave joproduktive,<sup>118</sup> mosrespektimin e afateve ligjore,<sup>119</sup> seanca ku të pandehurit përfaqësoheshin nga mbrojtësi sipas detyrës zyrtare<sup>120</sup> dhe seanca të mbyllura.<sup>121</sup>

---

117 Nuk është dhënë një kornizë kohore specifike për këto raste të referuara. Statistikat që kanë regjistruar numrin e rasteve të referuara nga NjIF në polici/Njësinë Speciale për Ndjekjen Penale të Terrorizmit për veprat që përfshijnë pretendime për financimin e terrorizmit nuk ishin të disponueshme dhe rastet e referuara nuk ishin regjistruar nga viti 2018 e tutje. Kishte mungesë të dukshme të regjistrimit të statistikave që analizonin rastet e supozuara të financimit të terrorizmit në përgjithësi.

118 Në një "seancë joproduktive" nuk ndodhi asgjë me vlerë apo substancë (nuk u administrua asnjë provë, nuk u dëgjua apo vendos për asnjë kërkesë, nuk u diskutuan çështje të menaxhimit të rastit, etj.) Burimi: OSCE Justice Monitor 2018, në dispozicion në: <https://www.osce.org/files/f/documents/4/b/446836.pdf>

119 Kodi i Procedurës Penale Nr. 04/L-123; Neni 314 Koha për përfundimin e shqyrtimit gjyqësor dhe 242 (4) (5) Procedura për ngritjen e aktakuzës, përkatësisht afati për caktimin e seancës fillestare.

120 *Po aty*. Neni 57, dhe 58.

121 *Po aty*. Neni 294.

### Vëzhgimet nga monitorimi gjyqësor 2018- 2020




Figura 9: Vëzhgimet nga monitorimi gjyqësor 2018 – 2020

Siç u theksua më lart, gjykatat kanë bërë progres të konsiderueshëm gjatë dy viteve të fundit, veçanërisht në lidhje me respektimin e afateve. Për shembull, në vitin 2018, nga gjithsej 87 seanca të monitoruara nga OSBE-ja, 55 afate nuk ishin respektuar. Në vitin 2019, numri i seancave ku nuk ishin respektuar afatet ishte 14 nga gjithsej 59 seanca. Megjithatë, për krahasim, në vitin 2020, nga 74 seanca të monitoruara nga OSBE, vetëm dy afate nuk u respektuan. Ne supozojmë, përmes pikëpamjeve të marra në intervistat me prokurorët dhe me avokatët mbrojtës, se ky përmirësim i atribuohet themelimit të Departamentit Special në Gjykatën Themelore të Prishtinës. Kjo duket se ka pasur ndikim pozitiv në përmirësimin e efikasitetit dhe menaxhimit të rasteve të lidhura me terrorizmin.

#### 5.1.6. Aktgjykimet dhe dënimet

Dënimet kryesore<sup>122</sup> për veprat e lidhura me terrorizmin janë edhe gjobat financiare,<sup>123</sup> edhe dënime me burgim që ndryshonin nga më e ulëta prej gjashtë muajsh burgim deri në maksimumin me burgim të përjetshëm.

122 Kodi Penal i Kosovës, nr. 06/L074 (14 janar 2019) (KP), përcakton llojet e dënimeve si në vijim: dënimet kryesore, dënimet alternative dhe dënimet plotësuese. Në kuadër të dënimeve kryesore, KP parashikon burgim të përjetshëm, dënim me burgim dhe dënim me gjobë, ndërsa në kuadër të dënimeve alternative, KP përcakton dënim me kusht, gjysmëlirinë dhe urdhët për punë në dobi të përgjithshme.

123 *Shih* nenin 46.1 Kodi Penal i Kosovës (KP), KODI NR. 04/L-082 “Dënimet me gjobë nuk mund të jetë më pak se njëqind (100) Euro evropiane (në tekstin e mëtejshëm “EURO”). Dënimet me gjobë nuk mund të tejkalojnë njëzet e pesëmijë (25.000) Euro ndërsa për veprat penale lidhur me terrorizëm, trafikim me njerëz, krim të organizuar ose veprat penale të kryera me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore nuk mund të tejkalojnë pesëqind mijë (500.000) Euro.

Gjatë periudhës së raportimit 2018-2020, të dhënat nga Gjykata Themelore e Prishtinës tregojnë se janë shpallur aktgjykime ndaj gjithsej 54 të pandehurve (25 gra dhe 29 burra).

### Ndarja gjinore në aktgjykimet për terrorizëm në Gjykatën Themelore të Prishtinës në periudhën 2018-2020




Figure 10: Ndarja gjinore në aktgjykimet për terrorizëm në Gjykatën Themelore të Prishtinës në periudhën 2018-2020<sup>124</sup>

### Aktgjykimet e gjykatave në rastet e lidhura me terrorizmin në Gjykatën Themelore të Prishtinës në periudhën 2018- 2020




Figura 11: Aktgjykimet e gjykatave në rastet e lidhura me terrorizmin në Gjykatën Themelore të Prishtinës në periudhën 2018- 2020<sup>125</sup>

124 Shifrat e siguruara nga regjistri gjyqësor.

125 Shifrat e siguruara nga regjistri gjyqësor.

### Dënimet në rastet e lidhura me terrorizmin në Gjykatën Themelore të Prishtinës në periudhën 2018- 2020




Figure 12: Dënimet në rastet e lidhura me terrorizmin në Gjykatën Themelore të Prishtinës në periudhën 2018- 2020<sup>126</sup>

Vlen të përmendet se në vitin 2020, nga 21 dënime pas marrëveshjeve për pranim të fajësisë, 20 ishin me të pandehura gra.<sup>127</sup>

126 Shifrat e siguruara nga regjistri gjyqësor.

127 Kodi nr. 04/L-082 Kodi Penal i Kosovës 2012, neni 143, "Organizimi dhe pjesëmarrja në grup terrorist".

## Rezultati i rasteve të lidhura me terrorizmin më 2019




Figure 13: Rezultati i rasteve të lidhura me terrorizmin më 2019

### Rezultati i rasteve të lidhura me terrorizmin më 2020




Figure 14: Rezultati i rasteve të lidhura me terrorizmin më 2020

Ka pasur rritje dramatike të numrit të dënimeve sipas nenit 143(2) të KP 2012, në lidhje me organizimin dhe pjesëmarrjen në një grup terrorist. Para vitit 2019, nuk kishte pasur dënime sipas këtij neni. Nga ata që u kthyen dhe u riatdhesuan në vitin 2019, pesë persona u dënuan për vepra në lidhje me pjesëmarrjen në grup terrorist, ku shumica dërrmuese e tyre pranuan fajësinë.

Në vitin 2020, OSBE-ja vërejti se individët që pranorin fajësinë kryesisht ishin gra, gjersa ishte vetëm një burrë i cili ishte dënuar pas marrëveshjes për pranim të fajësisë.<sup>128</sup> Të gjitha gratë u dënuan me kusht me dy vite burgim, me periudhë verifikim prej dy deri tri vite. Më 2018 Gjykata Supreme e Kosovës nxori *Udhëzuesin për politikën ndëshkimore*, sipas së cilës për veprat penale për cilat parashihet ndëshkim nga pesë deri 10 vite burgim mund të shqiptohen dënime me kusht, nëse aplikohen rrethanat lehtësuese.<sup>129</sup> Gjatë këtij hulumtimi, avokati mbrojtës ka theksuar se shpeshherë ka vlerësim joadekuat të rrethanave lehtësuese dhe rënduese gjatë shqiptimit të dënimit. Kjo çështje është ngritur edhe në raste të mëparshme por nuk ka pasur dëshmi të përmirësimit.<sup>130</sup> Monitoruesit e gjykimeve nga OSBE-ja gjithashtu kanë ngritur shqetësimin se dënimet nuk ishin transparente dhe dështimet e gjykatave për ta shpjeguar qartë arsyetimin e tyre gjatë dhënies së dënimit ka mundur të krijojë përshtypje të gabuara të njëanshmërisë ose trajtimit të pabarabartë.

128 Shih fusnotën 95.

129 Shih *Udhëzime për politikën e dënimit – Botimi i parë*, Gjykata Supreme e Kosovës, 2018, f. 200, në dispozicion në [https://supreme.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/legalOpinions/SentencingGuidelines\\_shkurt2018.pdf](https://supreme.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/legalOpinions/SentencingGuidelines_shkurt2018.pdf).

130 Raporti i OSBE-së, *Vlerësimi joadekuat i rrethanave lehtësuese dhe rënduese nga gjykatat*, Botimi 5, (korrik 2010). Në dispozicion në <https://www.osce.org/files/f/documents/9/5/70907.pdf>.

Përmes intervistave kualitative është identifikuar një çështje e përsëritur, ku dënimet në Gjykatat Themelore ankimohen në Gjykatën e Apelit, aktgjykimet shfuqizohen dhe lëndët kthehet në Gjykatën Themelore përkatëse për rigjykim. Në një rast me disa transferime, Gjykata e Apelit shqyrtoi vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe konstatoi se ka mungesë të qartësisë, por pa paraqitur arsytim të plotë dhe të qartë dhe pa përmbushur testet e provave të parashikuara me nenin 361, pikat 1 dhe 2, KPP (Baza e aktgjykimimit). Aktgjykimi përmbante vetëm një rideklarim të procesverbalit të seancave, por asnjë analizë të provave në mbështetje të shpalljes së fajësisë.<sup>131</sup>

Intervistat e kryera me gjyqtarët e Gjykatës Themelore për këtë rast në dhjetor 2020 përshkruan sfidat në përcaktimin e peshës që duhet t'i jepet provave të palëve të treta të marra nga fushëbetejat në Siri. Nuk ka hetues kosovarë në terren për të verifikuar materialin në të cilin është ofruar mbështetja, si është marrë i njëjti dhe nëse ka mendime të ndryshme nga ato që ofrohen nga palët e treta. Pjesa më e madhe e materialit është marrë nga bashkëpunimi mes autoriteteve. Pësia e provës që duhet t'i jepet këtij materialit shpesh çoi në mospërputhje në qasje në mes të Gjykatës Themelore dhe Gjykatës së Apelit.

Gjyqtarët e intervistuar githashtu ngritën shqetësimin e mungesës së trajnimeve specifike mbi peshën e provave që duhet t'i jepet materialeve të palëve të treta dhe theksuan nevojën për trajnime ligjore në qasjen që duhet ushtruar ndaj këtyre materialeve në gjykime.

Për sa i përket dënimit të personave të kthyer dhe të riatdhesuar, gjegjësisht grave nga zonat e konfliktit, në prill të vitit 2019 një gjyqtar theksoi se Kosova ishte një prej shteteve të para që pranuan personat e kthyer dhe të riatdhesuar nga Siria. Në lidhje me politikat e dënimit, për gratë e kthyer dhe të riatdhesuara janë marrë parasysh këto rrethana: gjendja mendore, logjistika, mbikëqyrja, riintegrimi, roli/kontributi në aktin e terrorizmit dhe kushtet ekonomike. Një gjyqtar shprehu pikëpamjen se shumica dërrmuese e grave e kthyer ose të riatdhesuara, nëse jo të gjitha, u dënuan për një lloj pjesëmarrjeje dhe mbështetjeje logjistike dhe jo për pjesëmarrje aktive në luftime. Si rezultat, perceptimi i gjyqtarit ishte se gratë e kthyer apo të riatdhesuara nuk kanë përbëjnë fare rrezik për shoqërinë. Prandaj, gjyqtari deklaroi se dënimet e shqiptuara ishin adekuate për mbrojtjen e publikut dhe për qëllim të dënimit.

Urdhërimi i trajtimit psikologjik për gratë si pjesë e dënimeve të tyre duket të jetë shqiptuar në mënyrë arbitrare pa konsideruar nëse ka pasur nevojë specifike për këtë masë; monitorimi i respektimit të këtij urdhri i delegohet menaxherëve të kryesve. Pasi të jetë përmbushur urdhri (zakonisht pas një periudhe prej dy vjetësh), kishte pak mbështetje të mëtejshme në dispozicion.

---

131 Atdhe Arifi et al.



Qendrat për Punë Sociale nuk kanë burime dhe kushte adekuate për të lehtësuar kujdesin e fëmijëve apo për t'i mbështetur nënat që përballen me urdhra të tillë.<sup>132</sup> Në intervista janë ngritur pyetje nëse trajtimi psikologjik ishte efektiv kur flitej për ideologjinë e një personi.

Në një takim tjetër në gusht 2020, një prokuror nga Zyra e Prokurorisë Speciale tregoi se prokurorët ndonjëherë përballen me sfida në rastet e lidhura me terrorizmin që përfshinin juridiksione jashtë Kosovës dhe, në këto raste, mbledhja e provave ishte e vështirë për shkak të problemeve me kanalet diplomatike/bashkëpunimin juridik ndërkombëtar. Në këtë drejtim, ai theksoi se Ambasada e SHBA-së në Prishtinë [SHBA/Departamenti i Drejtësisë, FBI] po luan një rol mbështetës.

Në intervista, gjyqtarët vazhdimisht ngritën mungesën e stafit mbështetës, përfshirë këshilltarët ligjorë. Ekziston rreziku që mungesa e infrastrukturës së duhur do të ketë ndikim negativ në cilësinë e gjykimeve.

---

132 Në lidhje me këtë, OSBE-ja së fundi publikoi një raport me rekomandime për Ministrinë e Shëndetësisë për ofrimin e mbështetjes së mjaftueshme logjistike dhe lehtësirave për QPS-të, në mënyrë që ato t'i përmbushin obligimet e tyre siç kërkohet me ligj [...]. Shih *FËMIJËT NË RADHË TË PARË: Roli i qendrave për punë sociale në procedurat gjyqësore*, Rekomandimet, në dispozicion në <https://www.osce.org/files/f/documents/b/3/453780.pdf>.

## 6. REKOMANDIME

Në vijim janë rekomandimet lidhur me gjetjet si më sipër:

### Reforma ligjore për financimin e terrorizmit

- Të ndryshohet e plotësohet ligji për parandalimin e pastrimit të parasë dhe luftimin e financimit të terrorizmit për ta sjellë atë në përputhje me standardet e BE-së dhe standardet ndërkombëtare.

### Përshtatshmëria e aktakuzave dhe zbulimi i informacionit

- Prokurorët të sigurojnë që aktakuzat kanë prova të mjaftueshme, të siguruara sipas kodit përkatës penal, me zbulim të plotë të informacionit për palën mbrojtjese në fazën paraprake.
- Mbrojtja të jetë vigjilente ndaj rasteve sfiduese kur nuk ka prova ose ka prova të pamjaftueshme që mbështesin paraburgimin dhe/ose aktakuzën.
- Të zhvillohet një sistem zyrtar i zbulimit; prokurorët të fokusohen në kërkesën për zbulim të materialeve që mund ta ndihmojnë mbrojtjen.
- T'u kushtohet konsideratë më e madhe trajtimit të personave me probleme të shëndetit dhe gjendjes mendore.
- Aplikimi rigoroz i dorëzarisë dhe largimi i lidhjes së perceptuar midis marrëveshjes së pranimit të fajësisë dhe lirimit nga paraburgimi.

### Trajnim dhe bashkëpunim më i madh

- Të avancohen shkathtësitë e gjyqtarëve me anë të trajnimeve specifike mbi pranueshmërinë dhe peshën që duhet t'u jepet provave të palëve të treta në gjykime penale.
- Të zhvillohen programe të përshtatshme të deradikalizimit që janë kulturalisht të përshtatshme për kontekstin e Kosovës me ndihmën e organizatave ose ekspertëve.
- Policia e Kosovës dhe NJIF të konsiderojnë intensifikimin e bashkëpunimit me prokurorinë në hetimin e financimit të terrorizmit; një taskforcë e përbashkët për mbikëqyrjen e punës në këtë fushë, krahas trajnimeve specifike për ndjekjen penale të financimit të terrorizmit, mund të çojë në bashkëpunim dhe besim më të madh në përdorimin e këtyre dispozitave brenda KP 2019.
- Trajnime për policinë mbi shfrytëzimin e teknologjisë së re që përdoret nga personat e përfshirë në aktivitete terroriste.
- Trajnime për prokurorë mbi standardet e GJEDNJ-së në fushën e paraburgimit, provave të përgjimit të fshehtë, akuzave, aktakuzave dhe detyrimit të zbulimit.
- Trajnime për avokatëve mbrojtës mbi standardet e GJEDNJ-së në fushat e së drejtës së klientit të tyre për lirim me kusht, aftësisë për t'u deklaruar mbi fajësinë, mjaftueshmërisë së provave për të mbështetur paraburgimin,

akuzën, aktakuzën, shëndetin mendor të klientit, zbulimin dhe pranueshmërinë e provave.

- Konsideratë më e madhe nga prokurorët lidhur me atë se kur rastet duhet të bashkohen në vend se të gjykohen individualisht; ndjekja penale e grupeve terroriste dhe jo e individëve.
- Përdorimi i kompetencave ligjore për të mbledhur inteligjencë dhe bashkëpunimi nga të dyshuarit për terrorizëm dhe/ose ata që janë dënuar.
- Punë më e ngushtë ndërmjet institucioneve kundër terrorizmit dhe krimeve të rënda.

## **Burimet**

- Caktimi i këshilltarëve ligjorë për gjyqtarët dhe prokurorët për të përmirësuar efikasitetin dhe cilësinë e gjykimeve.

## 7. PËRFUNDIME

Institucionet e drejtësisë penale luajnë rol vendimtar në luftimin e terrorizmit; çrrënjosjen e terrorizmit përmes hetimit, ndjekjes penale efektive dhe gjykimit të drejtë të rasteve.

Zhvillimet e kohëve të fundit, gjegjësisht themelimi i dy departamenteve, atij të Terrorizmit në Zyrën e Prokurorit Special dhe Departamentit Special në Gjykatën Themelore të Prishtinës, janë tregues kyçë të suksesit se institucionet e Kosovës janë të zotuar për përgjigje të fortë dhe efektive ndaj terrorizmit.

Legjislacioni i Kosovës kundër terrorizmit është përgjithësisht në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe evropiane. Megjithatë, ligji për parandalimin e pastrimit të parasë dhe luftimin e financimit të terrorizmit duhet të ndryshohet dhe plotësohet dhe të harmonizohet me legjislacionin e Be-së.

Janë vërejtur trende pozitive edhe në fushën e menaxhimit të rasteve gjyqësore, ku është ulur numri i seancave pas afateve të përcaktuara nga gjykata në vitin 2020, krahasuar me dy vitet e mëparshme.

Gjithashtu, bazuar në intervistat e realizuara, ekziston një nivel i mirë i bashkëpunimit ndërinstytucional. Megjithatë, mungesa e mbikëqyrjes dhe një task force të përbashkët në fushën e financimit të terrorizmit mbetet pengesë thelbësore për ndjekjet e suksesshme penale.

Si përfundim, institucionet dhe pjesëmarrësit e drejtësisë penale në Kosovë janë të përkushtuar dhe tejet të motivuar në rastet e lidhur me terrorizmin. Ngritja e fokusuar dhe strategjike e kapaciteteve të institucioneve kyçe do të promovojë respektimin e të drejtave të njeriut si dhe ndjekjet efektive të veprave terroriste.

## SHTOJCA I

### Përkufizimi i Terrorizmit dhe Diskutime.

- “Strategjia e Kosovës kundër Terrorizmit dhe Plani i Veprimit 2018-2022”<sup>133</sup> theksojnë se “terrorizmi mbetet një nga kërcënimet kryesore për sigurinë kombëtare dhe globale, duke kërcënuar jo vetëm jetën dhe pronën, por edhe vlerat demokratike dhe mënyrën e jetesës së shoqërisë. Përgjigja efektive ndaj terrorizmit kërkon përfshirje dhe bashkëpunim të të gjitha institucioneve publike, shoqërisë civile, organizatave ndërkombëtare dhe qytetarëve”.
- Edhe pse bashkësia ndërkombëtare ka miratuar një sërë traktatesh ndërkombëtare për luftimin e llojeve të veçanta të terrorizmit, siç është rrëmbimi i avionëve, në nivel të Kombeve të Bashkuara deri më sot nuk ka pasur pajtim mbi një përkufizim të terrorizmit.
- Nuk ka një përkufizim të vendosur të terrorizmit në të drejtën ndërkombëtare, përkundër përpjekjeve të shumta për të arritur një të tillë nga organizatat ndërqeveritare, qeveritë dhe akademikët. Një gjyqtar i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë ka theksuar se: *“Terrorizmi është term pa ndonjë rëndësi juridike. Është thjesht një mënyrë e përshtatshme për të aluduar në aktivitete, qofshin ato të shteteve apo individëve, përgjithësisht të pamiratuara dhe në të cilat janë të paligjshme metodat e përdorura, ose objektivat e mbrojtura, ose të dyja.”*<sup>134</sup>
- Megjithatë, përdorimi i saktë i fjalës “terrorizëm” është i rëndësishëm pasi rrjedhin pasoja ligjore në lidhje me bashkëpunimin midis shteteve, si shkëmbimi i inteligjencës, ndihma e ndërsjellë juridike, ngrirja e aseteve dhe konfiskimi dhe ekstradimi.
- Përpjekja e parë për të përkufizuar terrorizmin në një instrument ndërkombëtar ishte në Konventën e Lidhjes së Kombeve më 1937 për Parandalimin dhe Ndëshkimin e Gjenocidit, e cila përkufizoi terrorizmin si: *çdo veprim kriminal të drejtuar kundër një shteti dhe që synon ose llogaritet të krijojë një gjendje terrori në mendjet e personave të caktuar ose një grupi personash ose publikut të gjerë.”*<sup>135</sup> Përkufizimi i Konventës u kritikua se ishte shumë i gjerë dhe nuk hyri kurrë në fuqi. Ai mori mbështetje të pamjaftueshme nga qeveritë.

133 Strategjia e Kosovës kundër Terrorizmit dhe Plani i Veprimit 2018-2022, Shtator 2017, faqe 4. Në dispozicion në: [https://wb-iisg.com/wp-content/uploads/bp-attachments/6125/2-anglisht-National-Strategy-Against-Terrorism-and-Action-Plan-2018-2022\\_12-October\\_without-action-plan-1.pdf](https://wb-iisg.com/wp-content/uploads/bp-attachments/6125/2-anglisht-National-Strategy-Against-Terrorism-and-Action-Plan-2018-2022_12-October_without-action-plan-1.pdf)

134 R. Higgins, The General International Law of Terrorism in R. Higgins/M. Flory, E drejta ndërkombëtare dhe terrorizmi (1997).

135 Neni 1(2), Konventa e Lidhjes së Kombeve për Parandalimin dhe Ndëshkimin e Gjenocidit, në dispozicion në [https://legal.un.org/avl/pdf/ls/RM/LoN\\_Convention\\_on\\_Terrorism.pdf](https://legal.un.org/avl/pdf/ls/RM/LoN_Convention_on_Terrorism.pdf) (qasur më 19 maj 2021).

- Megjithatë, nga një vështrim i përgjithshëm i jurisprudencës ndërkombëtare, elementët e terrorizmit mund të konsiderohen se përfshijnë karakteristikat e mëposhtme:
  - natyra e tij e organizuar (nëse organizata e përfshirë është e madhe apo e vogël);
  - rrezikshmëria e tij (për jetën, gjymtyrët dhe pronën);
  - përpjekja e saj për të minuar qeverinë në veçanti (duke kërkuar të ndikojë politikën dhe ligjvënësit);
  - rastësia e tij dhe përhapja pasuese e frikës/terrorit në një popullatë.
- Përfundimisht, aktet terroriste janë akte kriminale dhe i nënshtrohen rreptësisë dhe masave mbrojtëse normale të ligjit penal. Nuk ka dallim për zbatueshmërinë e standardeve të drejtave të njeriut nëse rasti në shqyrtim konsiderohet të jetë akt terrorist në krahasim me çdo akt tjetër të rëndë penal.<sup>136</sup>
- Mbretëria e Bashkuar, Shtetet e Bashkuara dhe Franca kanë sisteme ligjore që janë të njohura për Kosovën dhe janë angazhuar në zhvillimin e vazhdueshëm të kornizave të tyre ligjore rreth terrorizmit në vitet e fundit.
- Në Angli dhe Uells, përkufizimi i terrorizmit u zhvillua gjatë historisë së tij në kodifikim në ligjin e Anglisë dhe Uellsit në Aktin e Terrorizmit 2001:

*"përdorimi ose kërcënimi krijohet për të ndikuar në qeverinë ose në organizata ndërkombëtare qeveritare ose për të frikësuar publikun ose një pjesë të publikut, dhe përdoret ose kërcënimi i përdorimit bëhet me qëllim të avancimit të një kauze politike, fetare, racore ose ideologjike".<sup>137</sup>*

- Përkufizimi është i gjerë dhe është shqyrtuar nga Gjykata e Lartë e Mbretërisë së Bashkuar në rastin *R kundër Gul*:

*"Në raportin e tij të dytë, z. Anderson<sup>138</sup> përmendi 'zbatimin e mundshëm të Akteve të Terrorizmit edhe për forcat e Mbretërisë së Bashkuar të përfshira në konflikte jashtë shtetit' dhe iu referua faktit që një raport i fundit australian 'rekomandoi që ligji australian të ndryshohet në mënyrë që të parashohë që pjesët përkatëse të Kodit Penal, sikurse në Kanada, nuk zbatohen për aktet e kryera nga palët e rregulluara nga ligji i konfliktit të armatosur.'"<sup>139</sup>*

<sup>136</sup> Luftimi i terrorizmit, mbrojtja e të drejtave të njeriut, *Doracak*, OSBE ODIHR 2007.

<https://www.osce.org/files/f/documents/d/6/29103.pdf>

<sup>137</sup> Akti i Terrorizmit 2001 s 1(1)(b); shih gjithashtu ss 1(2), (3).

<sup>138</sup> Në atë kohë Rishikues i Pavarur i Legjislacionit të Terrorizmit në Mbretërinë e Bashkuar.

<sup>139</sup> Shqyrtuar në rastin F [2007] EWCA Crim 243.

- Në Shtetet e Bashkuara, Kodi i Rregulloreve Federale përcakton terrorizmin.<sup>140</sup> Ligji Patriot 2001<sup>141</sup> ripërcaktoi përkufizimin e Kodit për terrorizmin dhe e zgjeroi atë për të mbuluar "terrorizmin e brendshëm".<sup>142</sup> Në Francë, është Kodi Penal Francez i cili liston veprat që përbëjnë akte terrorizmi.<sup>143</sup>
- Kemi vërejtur se në Angli dhe Uells ka vepra që nuk akuzohen sipas legjislacionit terrorist, por janë përcaktuar të jenë akte "terrorizmi". Gjyqtari mund të ftohet për të përcaktuar nëse vepra në këtë rast ka "lidhje terroriste".<sup>144</sup> Në seancën e dënimit, gjyqtarit mund t'i kërkohet të bëjë përcaktim të ngjashëm në kontekstin e dënimit.<sup>145</sup> Kur i pandehuri dënohet për vrasje, gjyqtari gjykues mund të shqyrtojë nëse vrasja është kryer "për qëllim të avancimit të një kauze politike, fetare, racore ose ideologjike".<sup>146</sup> Prandaj, vrasja e paligjshme mund të sanksionohet si vrasje terroriste pa përdorur vepra të veçanta të përshkruara sipas Aktit të Terrorizmit 2000.
- Standardet moderne të të drejtave të njeriut janë të rrënjësura në katër vlerat e mëposhtme të thjeshta, që janë liria nga mungesa; liria nga frika; liria e besimit; dhe liria e shprehjes.
- Këto liri përbëjnë parimet thelbësore të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut (UDHR), e cila përcakton elementet themelore të të drejtave ndërkombëtare të njeriut të pranuar nga shtetet anëtare të Kombeve të Bashkuara dhe të përpunuara në shumë traktate të mëvonshme të të drejtave të njeriut. DUDNJ pranohet si "standard i përbashkët i arritjes për të gjithë popujt dhe të gjitha kombet".<sup>147</sup>

---

140 Kodi i Rregulloreve Federale të SHBA-së, Titulli 18, Kreu 113B.

141 Nënkupton U.S.A.P.A.T.R.I.O.T. "Bashkimi dhe Forcimi i Amerikës duke siguruar mjetet e duhura të nevojshme për të kapur dhe penguar terrorizmin". (ang.: Uniting and Strengthening America by Providing Appropriate Tools Required to Intercept and Obstruct Terrorism'.)

142 Kodi i Rregulloreve Federale të SHBA-së, Titulli 18, Kreu 113B s 2331: 'Një person përfshihet në terrorizëm të brendshëm nëse kryen një akt "të rrezikshëm për jetën e njeriut" që është shkelje e ligjeve penale të një shteti ose të Shteteve të Bashkuara, nëse akti duket se synon: (i) të frikësojë ose detyrojë një popullsi civile; (ii) të ndikojë në politikën e një qeverie me anë të frikësimit ose detyrimit; ose (iii) të ndikojë në sjelljen e një qeverie me shkatërrim masiv, vrasje ose rrëmbim'.

143 Kodi Penal (Francë), nenet 421-1, 421-2-2.

144 Ligji i Procedurës Penale dhe Hetimeve 1996.

145 Akti Kundër Terrorizmit i 1996 neni 30.

146 Akti i Drejtësisë Penale 2003 Shtojca 21 paragrafi 4(2)(c).

147 Luftimi i terrorizmit, mbrojtja e të drejtave të njeriut, *Doracak*, OSBE ODIHR 2007.

<https://www.osce.org/files/f/documents/d/6/29103.pdf>





